FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 16

Tiranë – E enjte, 22 janar 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 19.1.2026	Për disa ndryshime dhe një shtesë në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar.....	1575
Udhëzim i ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6, datë 30.12.2025	Për përcaktimin e rregullave për zbatimin e sistemeve inteligjente në fushën e transportit rrugor dhe lidhjet me mënyrat e tjera të transportit rrugor.....	1576
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 26, datë 9.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	1599
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 27, datë 9.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës.....	1600
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 28, datë 9.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës	1601
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 29, datë 9.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	1602
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 32, datë 12.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	1604
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 33, datë 12.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.	1605
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 34, datë 12.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar.....	1606

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 35, datë 12.1.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 1290, datë 3.12.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Irlandës".....	1609
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 40, datë 13.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	1609
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 41, datë 13.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	1611
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 42, datë 13.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.	1612
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 43, datë 13.1.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës.....	1613
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 44, datë 13.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës.....	1614
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 45, datë 13.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë...	1615
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 46, datë 13.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Rumanisë.....	1615
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 48 , datë 14.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	1617
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 49, datë 14.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	1620
Urdhër i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 51, datë 14.1.2026	Për delegim të përkohshëm kompetence.....	1621
Urdhër i ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 249, datë 30.12.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 170, datë 13.9.2022, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.....	1622

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1386, datë 18.12.2025	Për një ndryshim në urdhrin nr. 266, datë 29.8.2011, "Për miratimin e rregullores 'për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrore'"	1632
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 76, datë 2.12.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3981 (362), datë 23.9.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.	1633
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 347, datë 29.12.2025	Mbi miratimin e kodit të rrjetit mbi emergjencën dhe rivendosjen.....	1643
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 42, datë 22.12.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 37, datë 20.11.2025, "Për licencimin e shoqërisë rajonale ujësjellës-kanalizime fier sha".....	1673
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 47, datë 29.12.2025	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifor të shoqërisë rajonale ujësjellës-kanalizime lezhë sha.....	1674
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nr. 6284, datë 21.10.2025	Për shpalljen të zhdukur të shtetases Lindita Lezo.....	1676

UDHËZIM
Nr. 3, datë 19.1.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe një shtesë, si më poshtë:

1. Në pikën 2.3, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

a) në shembullin e 4-të, paragrafi me përmbajtje: "Nga shuma mujore e arkëtimeve nga TVMP-ja, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të arkëtimeve, 25 (njëzet e pesë)% e diferencës (25% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) së arkëtimeve e derdhin në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore. Pjesa tjetër e mbetur prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) % (75% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) paguhet për llogari të drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar DPSHTRR-ja (Drejtoria Rajonale Tatimore Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj) brenda datës 15 të muajit pasardhës", zëvendësohet me paragrafin me përmbajtje si vijon:

"Nga shuma mujore e arkëtimeve nga TVMP-ja, DPSHTRR-ja, pasi mban komisionin në masën 5 (pesë) % të totalit mujor të arkëtimeve, derdh diferencën e mbetur prej 95 (nëntëdhjetë e pesë) % në llogarinë bankare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), brenda datës 15 të muajit pasardhës.

DPSHTRR-ja i dërgon Ministrisë së Financave informacion mbi vlerën takuese për t'u shpërndarë sipas njësive të vetëqeverisjes vendore (25% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja), brenda datës 15 të muajit pasardhës.

Ministria e Financave do t'i dërgojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vlerën takuese për t'u shpërndarë sipas bashkive. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve transferon vlerën takuese të të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe pjesa tjetër mbetet në buxhetin e shtetit.";

b) në paragrafin e fundit, fjalia me përmbajtje: "DPSHTRR-ja llogarit dhe transferon për llogari të njësive të qeverisjes vendore shumën e të ardhurave që ju takojnë këtyre njësive nga taksa e mbledhur, si dhe deklarojnë dhe paguajnë në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore, shumën e mbetur, pasi zbritet vlera e komisionit që ata përfitojnë, si dhe vlera e transferuar te njësitë e qeverisjes vendore.", zëvendësohet me fjalinë me përmbajtje si vijon:

"DPSHTRR-ja llogarit dhe transferon në llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve shumën e të ardhurave nga taksa e mbledhur prej 95%, pasi zbresin vlerën e komisionit prej 5% që ata përfitojnë.".

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) shkronja "b.1", e pikës 3.1, ndryshohet si më poshtë:

"b.1 pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara ose të lëna në ruajtje me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjeti ose dokumentacioni i mjetit ka qenë i bllokuar dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegura, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë.";

b) shkronja "c", e pikës 3.4 ndryshohet si më poshtë:

"c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara ose të lëna në ruajtje me vendim të gjykatës, të prokurorisë, për periudhën në të cilën mjeti ose dokumentacioni i mjetit ka qenë i bllokuar dhe pagesat e taksës së mjeteve të vjedhura, të djegura, të shkatërruara nga aksidentet, të vërtetuara nga organet e prokurorisë.".

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

UDHËZIM
Nr. 6, datë 30.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ZBATIMIN E SISTEMEVE INTELIGJENTE NË FUSHËN E TRANSPORTIT RRUGOR DHE LIDHJET ME MËNYRAT E TJERA TË TRANSPORTIT RRUGOR[1]

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 77/2 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e veprimit

Ky udhëzim:

1. Përcakton rregullat për të mbështetur zbatimin dhe përdorimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të sistemeve inteligjente të transportit, në vijim të referuara si SIT, në mënyrë koherente dhe të koordinuar me sisteme të ngjashme të zbatuara dhe të përdorura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe parashikon kushtet e përgjithshme të nevojshme për këtë qëllim.

2. Rregullon disponueshmërinë e të dhënave dhe vënien në zbatim të shërbimeve të SIT-it brenda fushave prioritare të përcaktuara në nenin 2 të këtij udhëzimi, me mbulimin specifik gjeografik të përcaktuar në shtojcën III për të dhënat dhe me mbulimin specifik gjeografik të përcaktuar në shtojcën IV për shërbimet SIT.

3. Ky udhëzim zbatohet për aplikimet dhe shërbimet SIT në fushën e transportit rrugor dhe për ndërlidhjen e tyre me mënyrat e tjera të transportit, pa cenuar aspektet që lidhen me sigurinë kombëtare ose interesat e mbrojtjes kombëtare.

Neni 2
Fushat prioritare

1. Për qëllimet e këtij udhëzimi, fushat e mëposhtme konsiderohen prioritare për zhvillimin dhe përdorimin e specifikimeve dhe standardeve në përputhje me dispozitat e nenit 1:

a) Fusha prioritare I: Shërbimet SIT për informacionin dhe lëvizshmërinë;

b) Fusha prioritare II: Shërbimet SIT për udhëtimin, transportin dhe administrimin e trafikut;

c) Fusha prioritare III: Shërbimet SIT për sigurinë dhe sigurinë rrugore;

d) Fusha prioritare IV: Shërbimet SIT për lëvizshmërinë bashkëpunuese, të ndërlidhur dhe të automatizuar.

2. Zbatimi i fushave prioritare është përcaktuar në shtojcën I, pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

Neni 3
Veprimet prioritare

Brenda fushave prioritare, veprimet e mëposhtme konsiderohen si prioritare për zhvillimin dhe përdorimin e specifikimeve dhe standardeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në shtojcën I:

a) ofrimi i shërbimeve të informacionit për udhëtimet multimodale;

b) ofrimi i shërbimeve të informacionit në kohë reale për trafikun, siç përcaktohet në udhëzimin nr. 12, datë 30.12.2024, "Mbi ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale".

c) të dhënat dhe procedurat për ofrimin pa pagesë për përdoruesit, kur është e mundur, të informacionit minimal universal për sigurinë rrugore;

ç) ofrimi i harmonizuar i një shërbimi telefonik elektronik (eCall) ndërveprues;

[1] Ky udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë është plotësisht i përafruar me direktivën 2010/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 7 korrik 2010, për kuadrin për vënien në zbatim të Sistemeve Inteligjente të Transportit në fushën e transportit rrugor dhe për ndërlidhjet me mënyrat e tjera të transportit, OJ L 207, 6.8.2010, f. 1–13, CELEX 32010L0040, ndryshuar me direktivën (EU) 2023/2661 (CELEX 32023L2661) dhe është plotësisht i përafruar me vendimin zbatues të Komisionit (BE) 2025/264, të datës 11 nëntor 2024, që përcakton modelin që përfshin treguesit kryesorë të performancës për raportimin nga Shtetet Anëtare, sipas direktivës 2010/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (i njoftuar sipas dokumentit C(2024) 7744), OJ L 2025/264, 10.2.2025, f. 1–15, CELEX 32025D0264.

d) ofrimi i shërbimeve të informacionit dhe të rezervimit për vende parkimi të sigurta për automjetet për përdorim tregtar.

Neni 4
Përkufizime

Për qëllimet e këtij udhëzimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Sistemet inteligjente të transportit" ose "SIT" janë sistemet që përdorin teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit në fushën e transportit rrugor, duke përfshirë infrastrukturën, automjetet dhe përdoruesit, si dhe në menaxhimin e trafikut dhe të lëvizshmërisë, si dhe për ndërlidhjet me mënyrat e tjera të transportit;

2. "Ndërveprueshmëri" është kapaciteti i sistemeve dhe proceseve kryesore të biznesit për shkëmbimin e të dhënave dhe ndarjen e informacioneve dhe njohurive, duke mundësuar vijimësinë e shërbimeve të SIT-it;

3. "Aplikim i SIT-it" është një instrument apo procedurë/kuadër operacional për aplikimin e SIT-it;

4. "Shërbim i SIT-it" është ofrimi i një aplikimi të SIT-it përmes një kuadri organizativ dhe operacional të mirëpërcaktuar, me synimin për të kontribuar në sigurinë e përdoruesit, efikasitetin, lëvizshmërinë e qëndrueshme ose komoditetin, lehtësimin dhe mbështetur operacionet e transportit dhe të udhëtimeve;

5. "Ofrues i shërbimit të SIT-it" është çdo ofrues i një shërbimi SIT, publik ose privat;

6. "Përdorues i SIT-it" është çdo përdorues i aplikimeve, ose i shërbimeve të SIT-it, duke përfshirë udhëtarët, përdoruesit e pambrojtur të rrugëve, përdoruesit dhe operatorët e infrastrukturës së transportit rrugor, administratorët e parqeve/stacioneve/terminaleve të automjeteve dhe operatorët e shërbimeve të emergjencës;

7. "Përdorues të pambrojtur të rrugëve" është çdo përdorues jomotorik i rrugës, siç janë këmbësorët dhe çiklistët, si dhe motoçiklistët dhe personat me aftësi të kufizuara ose me lëvizshmëri dhe orientim të reduktuar;

8. "Pajisje lëvizëse" është çdo pajisje elektronike portative komunikimi ose informacioni që mund të mbahet brenda automjetit për të ndihmuar në drejtimin e mjetit dhe/ose në operacionet e transportit;

9. "Platformë" është çdo njësi e vendosur brenda ose jashtë automjetit që mundëson vënien në zbatim, ofrimin, shfrytëzimin dhe integrimin e aplikimeve dhe shërbimeve SIT;

10. "Arkitekturë" është projekti konceptual që përcakton strukturën, sjelljen dhe integrimin e një sistemi të caktuar në kontekstin përreth tij;

11. "Ndërfaqja" është struktura lidhëse ndërmjet sistemeve, e cila siguron mjetet përmes të cilave sistemet mund të komunikojnë dhe të ndërveprojnë;

12. "Pajtueshmëri" është aftësia e përgjithshme e një pajisjeje ose sistemi për të punuar me një tjetër pajisje ose sistem pa modifikime;

13. "Vijimësia e shërbimeve" është aftësia për të siguruar shërbime të pandërprera në rrjetet e transportit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

14. "Të dhëna rrugore" janë të dhënat mbi karakteristikat e infrastrukturës rrugore, duke përfshirë sinjalet rrugore fikse dhe karakteristikat rregullatore të sigurisë së tyre, si dhe infrastrukturën për rikarikimin dhe furnizimin me lëndë djegëse alternative;

15. "Të dhëna mbi trafikun" janë të dhënat historike dhe në kohë reale për karakteristikat e trafikut rrugor;

16. "Të dhëna të udhëtimit" janë të dhënat kryesore, si oraret dhe tarifat e transportit publik, të nevojshme për të dhënë informacion për udhëtimet multimodale para dhe gjatë udhëtimit, për të lehtësuar planifikimin, prenotimin dhe përshtatjen e tij;

17. "Specifikim" është çdo masë detyruese që përcakton rregulla të cilat përmbajnë kërkesa, procedura ose rregulla të tjera relevante;

18. "Standard" është çdo standard ndërkombëtar, standard evropian (EN), standard i harmonizuar ose standard shqiptar, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 5, 6, 7, 9 dhe 10 të nenit 3 të ligjit nr. 8970, datë 4.2.2008, "Për standardizimin", të ndryshuar;

19. "Sisteme inteligjente bashkëpunuese të transportit", ose "C-SIT", janë sisteme inteligjente të transportit që u mundësojnë përdoruesve të SIT-it të ndërveprojnë dhe të bashkëpunojnë, duke shkëmbyer mesazhe të sigurta dhe të besuara, pa pasur njohuri paraprake për njëri-tjetrin dhe në mënyrë jodiskriminuese;

20. "Shërbim C-SIT" është çdo shërbim SIT i ofruar nëpërmjet C-SIT;

21. "Disponueshmëria e të dhënave" është ekzistenca e të dhënave në një format digjital të lexueshëm nga makina;

22. "Pikë kombëtare aksesi" ose "PKA" është Autoriteti Rrugor Shqiptar, që përbën pikën e vetme të aksesit për të dhënat, siç përcaktohet në udhëzimin nr. 12, datë 30.12.2024, "Mbi ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale", dhe specifikimet e përmendura në nenin 7;

23. "Aksesueshmëria e të dhënave" është mundësia e kërkimit dhe e marrjes së të dhënave në një format digjital të lexueshëm nga makina;

24. "Shërbim i lëvizshmërisë digjitale multimodale" është shërbimi që ofron informacion mbi trafikun dhe të dhënat e udhëtimit, të tilla si vendndodhja e objekteve të transportit, oraret, disponueshmëria ose tarifat për më shumë se një mënyrë transporti, i cili mund të përfshijë module që mundësojnë kryerjen e rezervimeve, prenotimeve ose pagesave ose lëshimin e biletave;

25. "Informacion bazë" është informacioni brenda fushës së veprimit të këtij udhëzimi, që është përcaktuar si i rëndësishëm për informimin e përdoruesve të rrugës dhe të SIT-it, veçanërisht nga autoritetet rrugore, kur ato janë përgjegjëse për këtë informacion;

26. "Rrugë interurbane kryesore" është çdo rrugë e përcaktuar si e tillë nga ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 5
Specifikimet për veprimet në fushat prioritare

1. Për veprimet brenda fushave prioritare të përcaktuara në nenin 2 të këtij udhëzimi, zhvillohen specifikime të veçanta dhe aty ku është e përshtatshme edhe standarde të nevojshme.

2. Specifikimet e veçanta do të miratohen veçanërisht në lidhje me shërbimet e:

a) informacionit të trafikut në kohë reale;

b) informacionit për vendet e sigurta dhe të mbrojtura të parkimit;

c) informacionit minimal të trafikut të lidhura me sigurinë rrugore të ofruara pa pagesë;

ç) informacionit të udhëtimit multimodal;

d) thirrjes eCall;

dh) sistemeve inteligjente bashkëpunuese të transportit.

Neni 6
Vendosja e SIT-it

1. Specifikimet miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin dhe zbatohen për të gjitha shërbimet dhe aplikimet e SIT-it të përcaktuara në këtë udhëzim, në momentin e zbatimit të tyre, në përputhje me shtojcën II, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Pika Kombëtare e Aksesit për çdo specifikim të veçantë të përmendur në nenin 5 të këtij udhëzimi vepron në përputhje me parimet e përcaktuara në shtojcën II.

3. Autoritetet përgjegjëse të listuara në nenin 15 bashkëpunojnë përmes Komitetit të Transportit për Planifikimin e SIT-it, të përcaktuar sipas nenit 14 të këtij udhëzimi, me autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe me grupet përkatëse të interesit kombëtare ose ndërkombëtare në funksion të fushave prioritare, për sa kohë që nuk ka specifikime të miratuara.

4. Autoritetet përgjegjëse të listuara në nenin 15 bashkëpunojnë përmes Komitetit të Transportit për Planifikimin e SIT-it me autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe, sipas rastit, me autoritetet përkatëse të vendeve të rajonit, në kuadër të bashkëpunimit ndërrajonal të Traktatit të Komunitetit të Transportit, për realizimin e projekteve të koordinimit të mbështetura nga Bashkimi Evropian, dhe ku është e përshtatshme me palët e interesuara relevante, për aspektet operacionale të zbatimit të specifikimeve të miratuara nga Komisioni Evropian, konkretisht:

a) standardet dhe profilet e harmonizuara në nivelin e Bashkimit Evropian;

b) përkufizimet, metadatat, kërkesat e përbashkëta të cilësisë dhe aspektet në lidhje me ndërveprueshmërinë e arkitekturave të pikave kombëtare të aksesit;

c) kushtet për shkëmbimin e të dhënave, aksesin e sigurt, si dhe aktivitetet e përbashkëta të trajnimit dhe informimit.

5. Për sa u përket kërkesave për ofruesit e të dhënave, përdoruesit e të dhënave dhe ofruesit e shërbimeve të SIT-it, të përcaktuara në specifikimet e miratuara, autoritetet përgjegjëse të listuara në nenin 15 bashkëpunojnë përmes Komitetit të Transportit për Planifikimin e SIT-it me autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, në lidhje me praktikat për vlerësimin e

pajtueshmërisë me këto kërkesa, zhvillimin e mekanizmave për zbatimin e pajtueshmërisë dhe çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkufitar.

Neni 7
Specifikimet

1. Ministri përgjegjës për transportin miraton specifikimet e nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë, ndërveprimin dhe vazhdimësinë e vendosjes dhe përdorimin operativ të SIT-it për veprimet prioritare.

2. Ministri përgjegjës për transportin, pas miratimit të specifikimeve të nevojshme për veprimet prioritare, miraton specifikimet që sigurojnë pajtueshmërinë, ndërveprimin dhe vazhdimësinë e vendosjes dhe përdorimin operativ të SIT-it për veprimet e tjera në fushat prioritare.

3. Kur është e përshtatshme dhe në varësi të fushës së mbuluar nga specifikimi, ky përfshin një ose më shumë nga llojet e dispozitave të mëposhtme:

a) dispozita funksionale, që përshkruajnë rolet e palëve të ndryshme të interesit dhe qarkullimin e informacionit ndërmjet tyre;

b) dispozita teknike, që parashikojnë mjetet teknike për përmbushjen e dispozitave funksionale;

c) dispozita organizative, që përshkruajnë detyrimet procedurale të grupeve të ndryshme të interesit;

d) dispozita lidhur me shërbimet, që përshkruajnë nivele të ndryshme të shërbimeve dhe përmbajtjen e tyre për aplikacionet dhe shërbimet SIT.

4. Specifikimet, kur është e përshtatshme, duhet të bazohen në standardet të referuara në pikën 18, të nenit 4 dhe në përputhje me shtojcën II, të këtij udhëzimi.

5. Specifikimet përcaktojnë që ministri përgjegjës pas konsultimit me Komitetin të Transportit për Planifikimin e SIT-it, të miratojë rregulla shtesë për ofrimin e shërbimeve të SIT-it, përveç atyre të zbatuara në Bashkimin Evropian, për të gjithë territorin ose për një pjesë të territorit të Republikës së Shqipërisë. Këto rregulla shtesë nuk pengojnë ndërveprueshmërinë me aplikacionet dhe shërbimet e SIT të përdorura në Bashkimin Evropian.

6. Këto specifikime bazohen sipas rastit në standardet e referuara në pikën 18, të nenit 4, dhe janë në përputhje me shtojcën II, pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

7. Këto specifikime përfshijnë rregulla për vendosjen e parametrave që lidhen me cilësinë dhe përshtatshmërinë për përdorim. Sipas rastit, dhe veçanërisht për arsye sigurie dhe ndërveprueshmërie, specifikimet përfshijnë rregulla për vlerësimin e konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut, duke përfshirë një dispozitë mbrojtëse në përputhje me ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar.

8. Ministri përgjegjës për transportin mund të caktojë një ose më shumë organe kompetente për vlerësimin e pajtueshmërisë me kërkesat e miratuara në specifikime, në varësi të rregullave të veçanta të vlerësimit të përcaktuara në to.

9. Çdo specifikim mbulon jo më shumë se një fushë prioritare dhe miratohet për çdo veprim prioritar.

Neni 8
Disponueshmëria e të dhënave dhe vënia në zbatim e shërbimeve SIT

1. Informacioni bazë, me të dhënat për çdo zonë gjeografike publikohet dhe bëhet i disponueshëm në faqen e *web*-it të Pikës Kombëtare të Aksesit nga ofruesit e të dhënave, në përputhje me llojin e të dhënave dhe afatet e përcaktuara në shtojcën III.

2. Ofruesit e të dhënave përditësojnë dhe bëjnë të disponueshme pa vonesë në faqen e *web* të Pikës Kombëtare të Aksesit, të dhënat që i korrespondojnë informacionit bazë, të cilat janë krijuar ose përditësuar në ose pas datës së përcaktuar në kolonën e tretë të shtojcës III.

3. Ofruesit e të dhënave që publikojnë dhe bëjnë të disponueshëm në faqen e *web* të Pikës Kombëtare të Aksesit, lloje të tjera të dhënash, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, respektojnë afatet e përcaktuara në shtojcën III dhe i përditësojnë këto të dhëna kurdo që është e nevojshme.

4. Afatet për publikimin dhe bërjen të disponueshme të të dhënave për të cilat nuk është përcaktuar një afat në kolonën e katërt të shtojcës III, përcaktohen nga ministri përgjegjës për transportin.

5. Afatet e përcaktuara në shtojcën III, zbatohen vetëm për infrastrukturën ekzistuese. Për

infrastrukturën e re, të dhënat e përcaktuara në shtojcën III publikohen dhe bëhen të disponueshme në faqen e *web* të Pikës Kombëtare të Aksesit, në datën e hapjes së kësaj infrastrukture për trafikun rrugor.

6. Ofruesit e shërbimeve të SIT-it janë përgjegjës që shërbimet e SIT-it të përcaktuara në shtojcën IV të zbatohen për zonën gjeografike të mbuluar sa më shpejtë që është mundur dhe në asnjë rast, jo më vonë se datat korresponduese të përcaktuara në këtë Shtojcë.

Neni 9
Standardet

1. Në fushat prioritare dhe për veprimet prioritare zhvillohen standardet e nevojshme për të siguruar ndërveprueshmërinë, përputhshmërinë dhe vijimësinë për vënien në zbatim dhe përdorimin operacional të SIT-it. Për këtë qëllim, ministria përgjegjëse për transportin, pas konsultimeve me Komitetin e Transportit për Planifikimin e SIT-it, i propozon Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 15 të ligjit nr. 9870, datë 4.2.2008, "Për standardizimin", të ndryshuar, adoptimin e standardeve evropiane përkatëse, si standarde shqiptare.

2. Ministria përgjegjëse për transportin paraqet propozimin për institucionin përgjegjës për standardizimit, në përputhje me shtojcën II, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, si dhe çdo dispozitë funksionale të përfshirë në një specifikim të miratuar në përputhje me nenin 7.

Neni 10
Sistemi për administrimin e kredencialeve të sigurisë të C-SIT

1. Specifikimet për fushën prioritare të përmendur në nenin 2, pika 1, shkronja "d", të miratuara nga ministri përgjegjës për transportin, mbulojnë sistemin për administrimin e kredencialeve të sigurisë të C-SIT të përmendur në pikën 4.3 të shtojcës I. Specifikimet për këtë sistem përcaktojnë detyrat e autoriteteve të mëposhtme:

a) autoritetit përgjegjës për politikat e certifikatave të C-SIT;

b) administratorit të listës së besueshme të C-SIT;

c) pikës së kontaktit të C-SIT.

2. Ministri përgjegjës për transportin është përgjegjës për të garantuar kryerjen e detyrave nga këto autoritete.

Neni 11
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale në kuadër të zbatimit të aplikacioneve dhe shërbimeve SIT që janë objekt i këtij udhëzimi, bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe me dispozitat e ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, vetëm në masën që ky përpunim është i nevojshëm për funksionimin e duhur të aplikacioneve, shërbimeve dhe veprimeve të SIT-it të parashikuara në shtojcën I, me qëllim garantimin e sigurisë rrugore dhe përmirësimin e menaxhimit të trafikut.

2. Ofruesit e të dhënave, përdoruesit e të dhënave dhe ofruesit e aplikacioneve dhe shërbimeve SIT:

a) përcaktojnë kategoritë e të dhënave që i nënshtrohen përpunimit të të dhënave personale, sikurse përcaktuar në ligjin nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

b) përpara përdorimit të të dhënave bëjnë vlerësimin e ndikimit të përpunimit të të dhënave mbi mbrojtjen e të dhënave personale, sikurse përcaktuar në ligjin nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

c) kanë detyrimin të mbrojnë të dhënat personale nga keqpërdorimi, duke përfshirë edhe aksesin, modifikimin ose humbjen e paautorizuar të tyre.

3. Subjektet që zbatojnë aplikacionet dhe shërbimet e SIT-it përdorin të dhëna anonime kur anonimizimi është i mundur dhe qëllimet e përpunimit të të dhënave mund të arrihen me të dhëna të anonimizuara për funksionimin e duhur të aplikacioneve dhe shërbimeve të SIT-it, duke pasur parasysh kërkesat e pikës 1 të këtij neni.

4. Kur anonimizimi nuk është teknikisht i realizueshëm, ose qëllimet e përpunimit të të dhënave nuk mund të arrihen me të dhëna të anonimizuara, të dhënat të jepen me pseudonim, me kusht që pseudonimi të jetë teknikisht i realizueshëm

dhe qëllimet e përpunimit të të dhënave të mund të arrihen me përdorimin e të dhënave me pseudonim.

5. Të dhënat personale përpunohen vetëm në masën e nevojshme për funksionimin e duhur të aplikacioneve dhe të shërbimeve SIT dhe duke pasur parasysh kërkesat e pikës 1 të këtij neni.

Neni 12
Të dhënat e hapura dhe ripërdorimi i informacionit të sektorit publik

Në kuadër të zbatimit të aplikacioneve dhe shërbimeve SIT që janë brenda fushës së veprimit të këtij udhëzimi, përdorimi i të dhënave të hapura dhe ripërdorimi i informacionit të institucionet publike kombëtare apo vendore, kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 33/2022, "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 13
Përgjegjësia e ofruesit të aplikacioneve dhe shërbimeve SIT

Ofruesi i aplikacioneve dhe i shërbimeve SIT brenda fushës së veprimit të këtij udhëzimi, në përputhje me shtojcat III dhe IV, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara nga produktet me defekt në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 14
Rregullat mbi përgjegjësinë

1. Autoritetet përgjegjëse të sigurojnë që çështjet që lidhen me përgjegjësinë, për sa i përket vendosjes dhe përdorimin e aplikacioneve dhe shërbimeve të SIT-it të përcaktuara në specifikimet e miratuara sipas nenit 6, janë trajtuar në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar.

2. Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) administron:

a) Sistemin e menaxhimit të trafikut, që nënkupton një sistem, i cili konsiston në instalimin e pajisjeve stacionare trafikmatëse në akset kryesore të rrjetit rrugor kombëtar. Ky sistem i ofron ARRSH-së të dhëna trafiku në kohë reale dhe është në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, mbi monitorimin e trafikut në rrjetin rrugor kombëtar dhe udhëzimit nr. 12, datë 30.12.2024, "Mbi ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale".

b) Qendrën e Monitorimit dhe Kontrollit të Trafikut Rrugor, që ka për qëllim përfshirjen e shërbimeve SIT dhe për realizimin e këtij qëllimi, bashkëpunon me Institutin e Transportit dhe Policinë Rrugore.

c) Sistemin "WEB-GIS", që është një sistem i cili shërben si një inventar i hollësishëm i rrjetit rrugor kombëtar, duke ndihmuar në miradministrimin e të dhënave përkatëse. Ky sistem është ndërtuar në përputhje me standardet evropiane INSPIRE dhe ligjin nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor", të ndryshuar.

Neni 15
Planifikimi i aplikacioneve dhe i shërbimeve SIT

1. Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it harton planin për aplikimin e sistemeve inteligjente në transportin rrugor dhe monitoron zbatimin e tij.

2. Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it harton raportin vjetor për zbatimin e këtij plani.

3. Plani për aplikimin e sistemeve inteligjente në transportin rrugor miratohet nga ministri përgjegjës për transportin.

Neni 16
Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it

1. Në zbatim të këtij udhëzimi, krijohet Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it, për planifikimin e veprimeve prioritare, si dhe koordinimin e iniciativave në zbatim të teknologjive të informacionit të transportit rrugor dhe multimodal, në ndërveprim me llojet e tjera të transportit, siç janë ai hekurudhor dhe i kombinuar, detar dhe ajror, dhe sektorëve të infrastrukturës.

2. Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it kryesohet nga zëvendësministri përgjegjës për transportin rrugor dhe përbëhet nga përfaqësues të:

a) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

b) Autoritetit Rrugor Shqiptar;

c) Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;

ç) Institutit të Transportit;

d) Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

3. Në mbledhjet e Komitetit të Transportit për Planifikimin e SIT-it ftohen të marrin pjesë përfaqësues të këtyre institucioneve:

a) Ministrisë së Punëve të Brendshme/Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

b) Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit/ Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimi;

c) Ministrisë së Financave;

ç) Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor;

d) INSTAT-it;

dh) Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

e) Autoritetit të Konkurrencës.

Neni 17
Grupi këshillues për zbatimin e SIT-it

1. Për të përdorur në mënyrë efikase rrjetet e transportit rrugor dhe multimodal, formohet grupi këshillues për zbatimin e SIT-it, për të dhënë sugjerime për Komitetin e Transportit për Planifikimin e SIT, në aspektin tregtar dhe teknik të vendosjes dhe përdorimit të SIT-it, në të gjithë territorin shqiptar. Ky grup përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë, nga ofruesit e shërbimeve përkatëse SIT, shoqatat e përdoruesve të aplikacioneve SIT në sektorin e transportit dhe infrastrukturës, operatorët e transportit rrugor dhe multimodal në ndërveprim me llojet e tjera, shoqatat e bashkive etj.

2. Operatorët e tjerë përfshijnë, për sa është e mundur, transportuesit hekurudhorë dhe intermodal e të kombinuar, detar dhe ajror, si dhe operatorët e impianteve të shërbimit apo objekteve, industrinë e krijimit të këtyre aplikacioneve SIT, partnerët socialë, shoqatat profesionale, autoritetet lokale dhe forume të tjera përkatëse në platformat e konsultimit të autoriteteve përgjegjëse me palët e interesit.

3. Grupi këshillues dhe operatorët e tjerë, të cituar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, udhëzohen për të kontribuar, ku është e nevojshme, për zbatimin aktual dhe të mëtejshëm të dokumenteve strategjike në sektorin e transportit dhe veçanërisht në zbatimin dhe ofrimin e aplikacioneve dhe shërbimeve të SIT, në koordinimin e praktikave të tyre më të mira me veprimet prioritare të sektorit të transportit dhe infrastrukturës.

Neni 18
Raportimi

1. Brenda datës 21 mars 2026, Komiteti i Transportit për Planifikimin e SIT-it i paraqet ministrit përgjegjës për transportin, raportin fillestar mbi zbatimin e këtij udhëzimi dhe të urdhrave të miratuar mbi zbatimin e sistemeve inteligjente të transportit, si dhe mbi aktivitetet dhe projektet kryesore kombëtare, në lidhje me fushat prioritare dhe me disponueshmërinë e të dhënave dhe shërbimeve të renditura në shtojcat III dhe IV, pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

2. Modeli i raportit fillestar dhe i atyre të përparimit, duke përfshirë listën e treguesve kryesorë të performancës për vlerësimin e zbatimit të këtij udhëzimi dhe urdhrave për zbatimin e sistemeve inteligjente në transport është bashkëlidhur si shtojca V dhe shtojca VI pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

3. Raporti i parë i përparimit do të plotësohet brenda datës 21 mars 2028 dhe më pas çdo tre vjet mbi përparimin e bërë lidhur me zbatimin e këtij udhëzimi dhe të urdhrave të miratuar për zbatimin e sistemeve inteligjente në transport.

Neni 19
Dispozita të fundit

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen, të gjitha institucionet dhe subjektet e përmendura në këtë udhëzim.

2. Udhëzimi i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3616/3, datë 21.7.2017, "Për rregullat për zbatimin e sistemeve inteligjente në fushën e transportit rrugor dhe lidhjet me mënyrat e tjera të transportit", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

SHTOJCA I
FUSHAT PRIORITARE

1. Fusha prioritare I: Shërbimet SIT për informacionin dhe lëvizshmërinë

Specifikimet dhe standardet për shërbimet e SIT-it për informacionin dhe lëvizshmërinë për udhëtarët përfshijnë sa më poshtë:

1.1. Specifikimet për shërbimet e lëvizshmërisë digjitale multimodale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (përfshirë shërbimet e informacionit mbi udhëtimet multimodale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë).

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme në mënyrë që shërbimet e lëvizshmërisë digjitale multimodale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe shërbime të ngjashme që ofrojnë informacion ose veçori prenotimi ose blerjeje për më shumë se një operator transporti brenda së njëjtës mënyrë transporti të jenë të sakta dhe të disponueshme përtej kufijve për përdoruesit e SIT, bazuar në:

1.1.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë për ofruesit e shërbimeve të SIT të të dhënave ekzistuese dhe të sakta mbi trafikun dhe udhëtimet multimodale që përdoren për shërbimet e lëvizshmërisë digjitale multimodale, pa cenuar kufizimet e sigurisë dhe të menaxhimit të transportit;

1.1.2. lehtësimin e shkëmbimit ndërkufitar të të dhënave elektronike ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit përkatëse dhe ofruesve përkatës të shërbimeve të SIT-it, veçanërisht përmes ndërfaqeve të standardizuara;

1.1.3. përditësimin në kohë nga autoritetet publike dhe grupet e interesit përkatëse të të dhënave të disponueshme mbi trafikun dhe udhëtimet multimodale që përdoren për shërbimet e lëvizshmërisë digjitale multimodale;

1.1.4. përditësimin në kohë të informacionit mbi udhëtimet multimodale, duke përfshirë informacionin, në lidhje me prenotimet dhe blerjet, sipas rastit, të shërbimeve të transportit nga ofruesit e shërbimeve të SIT-it.

1.2. Specifikimet për shërbimet e informacionit mbi trafikun rrugor dhe navigimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (duke përfshirë shërbimet e informacionit mbi trafikun në kohë reale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë).

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme në mënyrë që shërbimet e informacionit mbi trafikun rrugor dhe të navigimit në mbarë BE-në të jenë të sakta dhe të disponueshme për përdoruesit ndërkufitarë të SIT, bazuar në:

1.2.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë për ofruesit e shërbimeve të SIT-it dhe grupet e tjera përkatëse të interesit, si dhe për përdorim në hartat digjitale, të të dhënave ekzistuese dhe të sakta mbi rrugët dhe trafikun, duke përfshirë të dhënat në kohë reale, që përdoren për informacionin mbi trafikun në kohë reale, pa cenuar kufizimet e sigurisë dhe të menaxhimit të transportit;

1.2.2. lehtësimin e shkëmbimit ndërkufitar të të dhënave elektronike ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit përkatëse dhe ofruesve përkatës të shërbimeve të SIT-it, duke përfshirë komentet mbi cilësinë e të dhënave;

1.2.3. përditësimin në kohë të të dhënave të disponueshme mbi rrugët dhe trafikun që përdoren për informacionin mbi trafikun në kohë reale nga autoritetet publike dhe grupet e interesit përkatëse;

1.2.4. përditësimin në kohë të informacionit mbi trafikun në kohë reale për përdoruesit e rrugëve dhe grupet e tjera përkatëse të interesit nga ofruesit e shërbimeve të SIT-it;

1.3. Specifikimet për shërbimet e lëvizshmërisë digjitale multimodale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe shërbimet e informacionit mbi trafikun rrugor dhe të navigimit;

1.3.1. Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për mbledhjen nga autoritetet publike përkatëse dhe/ose, sipas rastit, nga sektori privat, të të dhënave mbi rrugët dhe trafikun (pra planet e qarkullimit rrugor, rregullat e trafikut dhe rrugët e rekomanduara, veçanërisht për automjetet e rënda) dhe për ofrimin e tyre për ofruesit e shërbimeve të SIT, bazuar në:

1.3.1.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë, për ofruesit e shërbimeve të SIT-it, të të dhënave ekzistuese mbi rrugët dhe trafikun (pra planet e qarkullimit rrugor, rregullat mbi trafikun dhe rrugët e rekomanduara) të mbledhura nga autoritetet publike përkatëse dhe/ose sektori privat;

1.3.1.2. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave elektronike ndërmjet autoriteteve publike dhe ofruesve të shërbimeve të SIT-it dhe grupeve të tjera përkatëse të interesit;

1.3.1.3. përditësimin në kohë, nga autoritetet publike përkatëse dhe/ose, sipas rastit, nga sektori privat, të të dhënave mbi rrugët dhe trafikun (pra

planet e qarkullimit rrugor, rregullat e trafikut dhe rrugët e rekomanduara);

1.3.1.4. përditësimin në kohë, nga ofruesit e shërbimeve të SIT-it, të shërbimeve dhe aplikimeve të SIT që përdorin këto të dhëna mbi rrugët dhe trafikun.

1.3.2. Përcaktimi i kërkesave të nevojshme në mënyrë që të dhënat mbi rrugët, trafikun dhe udhëtimet përkatëse dhe infrastrukturën multimodale që përdoren për hartat digjitale të jenë të sakta dhe të disponueshme, kur është e mundur, për krijuesit e hartave digjitale dhe ofruesit e shërbimeve, bazuar në:

1.3.2.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë për krijuesit e hartave digjitale dhe ofruesit e shërbimeve të të dhënave ekzistuese mbi rrugët, trafikun dhe udhëtimet përkatëse dhe infrastrukturën multimodale, duke përfshirë nyjat e identifikuara të aksesit, që përdoren për hartat digjitale;

1.3.2.2. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave elektronike ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit përkatëse dhe krijuesve privatë të hartave digjitale dhe ofruesve të shërbimeve;

1.3.2.3. përditësimin në kohë të të dhënave mbi rrugët dhe trafikun për hartat digjitale nga autoritetet publike dhe grupet e interesit përkatëse;

1.3.2.4. përditësimin në kohë të hartave digjitale nga krijuesit e hartave digjitale dhe ofruesit e shërbimeve.

2. Fusha prioritare II: Shërbimet e SIT-it për udhëtimin, transportin dhe administrimin e trafikut

Specifikimet dhe standardet për shërbimet e SIT-it për udhëtimin, transportin dhe administrimin e trafikut përfshijnë sa më poshtë:

2.1. Specifikimet për shërbimet e përmirësuara të menaxhimit të trafikut dhe incidenteve

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për të mbështetur dhe harmonizuar shërbimet e përmirësuara të menaxhimit të trafikut dhe incidenteve, bazuar në:

2.1.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e të dhënave ekzistuese dhe të sakta mbi rrugët dhe trafikun dhe të dhënave mbi aksidentet dhe incidentet që nevojiten për shërbimet e menaxhimit të trafikut dhe incidenteve;

2.1.2. lehtësimin e shkëmbimit ndërkufitar të të dhënave elektronike, duke përfshirë të dhënat mbi transportin e mallrave, që janë të rëndësishme për administrimin e trafikut dhe të incidenteve (p.sh. transporti i mallrave të rrezikshme, kufizimet e aksesit të lidhura me mallrat, ngarkesat që tejkalojnë përmasat e lejuara), ndërmjet qendrave të menaxhimit të trafikut, qendrave të informacionit mbi trafikun, grupeve të interesit dhe ofruesve të shërbimeve të SIT-it, veçanërisht përmes ndërfaqeve të standardizuara;

2.1.3. përditësimin në kohë të të dhënave të disponueshme mbi rrugët dhe trafikun dhe të dhënave mbi aksidentet dhe incidentet që nevojiten për shërbimet e përmirësuara të menaxhimit të trafikut dhe incidenteve nga grupet të interesit përkatëse;

2.1.4. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e të dhënave dhe sinergjitë me nisma të tjera që synojnë mbështetjen e multimodalitetit, integrimin e mënyrave të transportit dhe lehtësimin e kalimit modal në rrjetin evropian të transportit drejt mënyrave më të qëndrueshme të transportit, nëpërmjet harmonizimit dhe lehtësimit të shkëmbimit të të dhënave.

2.2. Specifikimet për shërbimet e menaxhimit të lëvizshmërisë

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për të mbështetur zhvillimin e shërbimeve të sakta të menaxhimit të lëvizshmërisë nga autoritetet e transportit publik, bazuar në:

2.2.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë për autoritetet publike përkatëse, në një format të standardizuar, të të dhënave ekzistuese e të sakta mbi udhëtimet dhe trafikun rrugor dhe multimodal, që nevojiten për administrimin e lëvizshmërisë, pa cenuar kërkesat për mbrojtjen e të dhënave;

2.2.2. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave elektronike përtej kufijve ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit përkatëse dhe ofruesve përkatës të shërbimeve të SIT-it;

2.2.3. përditësimin në kohë të të dhënave të disponueshme mbi udhëtimet dhe trafikun rrugor dhe multimodal që nevojiten për administrimin e lëvizshmërisë nga autoritetet publike dhe grupet e interesit përkatëse.

2.3. Kuadri i BE-së për arkitekturën e SIT-it

Përcaktimi i masave të nevojshme për të zhvilluar një kuadër kombëtar për arkitekturën e SIT-it, që adreson në mënyrë specifike ndërveprueshmërinë e lidhur me SIT-et, vijimësinë e shërbimeve dhe aspektet e multimodalitetit, mbi bazën e të cilit autoritetet kompetente, në bashkëpunim me

sektorin privat, mund të zhvillojnë arkitekturën e tyre të SIT-it për lëvizshmërinë në nivel kombëtar, rajonal ose lokal.

2.4. Aplikimet SIT dhe logjistika e transportit të mallrave

Përcaktimi i kërkesave të nevojshme për të mbështetur realizimin e aplikimeve të SIT-it për logjistikën e transportit të mallrave, veçanërisht për gjurmimin dhe ndjekjen e mallrave dhe shërbimet e tjera të vizibilitetit përgjatë transportit të tyre multimodal, bazuar në:

2.4.1. disponueshmërinë e teknologjive përkatëse të SIT-it dhe përdorimin e tyre nga zhvilluesit e aplikimeve të SIT-it;

2.4.2. disponueshmërinë e të dhënave të lidhura me ngarkesën, të aksesueshme përmes kuadrove të tjera specifike të shkëmbimit të të dhënave

2.4.3. integrimin e rezultateve të pozicionimit në mjetet dhe qendrat e menaxhimit të trafikut.

3. Fusha prioritare III: Shërbimet SIT për sigurinë rrugore dhe mbrojtjen

Specifikimet dhe standardet për shërbimet e SIT-it për sigurinë rrugore dhe mbrojtjen përfshijnë sa më poshtë:

3.1. Specifikimet për shërbimin telefonik elektronik (eCall) ndërveprues në mbarë territorin e Republikës së Shqipërisë

Përcaktimi i masave të nevojshme për ofrimin e harmonizuar të një shërbimi telefonik elektronik (eCall) ndërveprues në mbarë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë:

3.1.1. disponueshmërinë e të dhënave të SIT-it brenda automjetit që janë të nevojshme për t'u shkëmbyer;

3.1.2. disponueshmërinë e pajisjeve të nevojshme në qendrat e përgjigjes ndaj thirrjeve emergjente që marrin të dhënat e dërguara nga automjetet;

3.1.3. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave elektronike ndërmjet automjeteve dhe qendrave të përgjigjes ndaj thirrjeve emergjente, duke përfshirë ndërveprimin e mundshëm me të dhënat e përfshira në aktin ligjor që rregullon komunikimin elektronik të informacionit rregullator dhe me Protokollin Shtesë të Konventës për Kontratën për Transportin Ndërkombëtar të Mallrave Rrugore (eCMR), në lidhje me elektronike të ngarkesës, sikurse aderuar me ligjin nr. 59/2025, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shtesë të Konventës për Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (CMR), në lidhje me faturën elektronike të ngarkesës, bërë në Gjenevë në datën 20.2.2008", si për shembull në rastin e mallrave të rrezikshme.

3.2. Specifikimet për shërbimet e informacionit dhe të rezervimit për vende parkimi të sigurta për kamionët dhe mjetet për përdorim tregtar

Përcaktimi i masave të nevojshme për të siguruar informacion të bazuar te SIT-it dhe, kur është e mundur, shërbimet e rezervimit për vende parkimi të sigurta për kamionët dhe mjetet për përdorim tregtar, veçanërisht në zonat e shërbimit dhe të pushimit në rrugë, bazuar në:

3.2.1. disponueshmërinë e informacionit mbi parkimin për përdoruesit;

3.2.2. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave elektronike ndërmjet vendeve dhe hapësirave të parkimit, qendrave dhe automjeteve;

3.2.3. integrimin e teknologjive përkatëse të SIT-it si në automjete, ashtu edhe në mjediset e parkimit, për të përditësuar informacionin mbi hapësirat e disponueshme të parkimit për qëllime rezervimi.

3.3. Specifikimet për informacionin universal minimal mbi trafikun në lidhje me sigurinë rrugore

Përcaktimi i kërkesave minimale për dhënien pa pagesë për përdoruesit, kur është e mundur, të "informacionit universal mbi trafikun", në lidhje me sigurinë rrugore, si dhe përcaktimi i përmbajtjes së tyre minimale, bazuar në:

3.3.1. disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e të dhënave të sakta mbi ngjarjet dhe kushtet e lidhura me sigurinë (rrugore) që nevojiten për informacionin mbi trafikun që lidhet me sigurinë dhe shërbimet e menaxhimit të incidenteve/ aksidenteve;

3.3.2. vënien në zbatim ose përdorimin e mjeteve për zbulimin ose identifikimin e ngjarjeve dhe kushteve të lidhura me sigurinë rrugore;

3.3.3. identifikimin dhe përdorimin e një liste të standardizuar të ngjarjeve të trafikut që lidhen me sigurinë rrugore ("mesazhet universale të trafikut"), e cila duhet t'u komunikohet përdoruesve të SIT-it pa pagesë;

3.3.4. pajtueshmërinë dhe integrimin e "mesazheve universale të trafikut" në shërbimet e SIT-it për informacionin mbi trafikun dhe udhëtimet multimodale.

3.4. Specifikimet për veprime të tjera

3.4.1. Përcaktimi i masave të nevojshme për të mbështetur sigurinë e përdoruesve të rrugës, në lidhje me ndërfaqen/ndërveprimin e tyre "njeri-makineri" *(Human-Machine Interface)* brenda mjetit

dhe përdorimin e pajisjeve nomade, duke përfshirë telefonat celularë, për të ndihmuar në drejtimin e mjetit dhe/ose funksionimin e transportit, si dhe sigurinë e komunikimeve brenda mjetit, të cilat nuk klasifikohen si automjete bujqësore dhe pyjore, mjete motorike me 2 ose 3 rrota ose kuadricikla, ose si automjete të kategorive M dhe N dhe rimorkio të kategorisë O.

3.4.2. Përcaktimi i masave të nevojshme për të përmirësuar sigurinë dhe komoditetin e përdoruesve të cenueshëm të rrugëve për të gjitha aplikimet përkatëse të SIT-it për mjetet të cilat nuk klasifikohen si automjete bujqësore dhe pyjore, mjete motorike me 2, 3 ose 4 rrota, ose si automjete të kategorive M dhe N dhe rimorkio të kategorisë O.

3.4.3. Përcaktimi i masave të nevojshme për integrimin e sistemeve të avancuara të informacionit për mbështetjen e drejtuesve në automjete dhe në infrastrukturën rrugore, të cilat nuk klasifikohen si automjete bujqësore dhe pyjore, mjete motorike me 2, 3 ose 4 rrota, ose si automjete të kategorive M dhe N dhe rimorkio të kategorisë O.

3.4.4. Përcaktimi i masave të nevojshme për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit ndërmjet ofruesve të shërbimeve për aplikimet e SIT-it për sigurinë, siç është mbështetja për rikuperimin e mjeteve ose mallrave të vjedhura, dhe autoriteteve publike përkatëse, duke marrë parasysh siç duhet kuadrot e tjera ekzistuese dhe ato në zhvillim e sipër që synojnë lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave mbi lëvizshmërinë dhe transportin që nuk klasifikohen si automjete bujqësore dhe pyjore, mjete motorike me 2, 3 ose 4 rrota, ose si automjete të kategorive M dhe N dhe rimorkio të kategorisë O.

4. Fusha prioritare IV: Shërbimet e SIT-it për lëvizshmërinë bashkëpunuese, të lidhur dhe të automatizuar

Specifikimet dhe standardet për lidhjen e automjeteve me infrastrukturën e transportit, rritjen e ndërgjegjësimit dhe mundësimin e shërbimeve të lëvizshmërisë me shkallë të lartë automatizimi përfshijnë sa më poshtë vijon, pa cenuar specifikimet dhe standardet që kanë të bëjnë me automjetet bujqësore dhe pyjore, mjetet motorike me 2, 3 ose 4 rrota, ose automjetet e kategorive M dhe N dhe rimorkiot e kategorisë O:

4.1. Përcaktimi i masave të nevojshme për të avancuar më tej zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve bashkëpunuese inteligjente të transportit (automjet-automjet, automjet-infrastrukturë, infrastrukturë-infrastrukturë), veçanërisht për të mbështetur mobilitetin bashkëpunues, të lidhur dhe të automatizuar (CCAM), bazuar në:

4.1.1. lehtësimin e shkëmbimit të të dhënave ose informacionit midis automjeteve, midis infrastrukturave dhe midis automjeteve dhe infrastrukturave, si dhe midis përdoruesve të tjerë të rrugës dhe automjeteve dhe infrastrukturave;

4.1.2. disponueshmërinë e të dhënave ose informacioneve përkatëse që duhet të shkëmbehen për palët përkatëse, qoftë automjet apo infrastrukturë rrugore;

4.1.3. përdorimin e një formati të standardizuar të mesazheve për shkëmbimin e të dhënave ose informacionit midis automjetit dhe infrastrukturës;

4.1.4. përcaktimin e një infrastrukture të saktë dhe të besueshme të komunikimit për shkëmbimin e të dhënave ose informacionit midis automjeteve, midis infrastrukturave dhe midis automjeteve dhe infrastrukturave;

4.1.5. përdorimin e proceseve të standardizimit për të miratuar arkitekturat përkatëse.

4.2. Specifikimet për shërbimet

4.2.1. Shërbimet e C-SIT për informacionin dhe për paralajmërimin bazuar në të dhënat mbi statusin, që rrisin ndërgjegjësimin e përdoruesve të transportit për situatat e ardhshme të trafikut;

4.2.2. Shërbimet e C-SIT për informacionin dhe për paralajmërimin bazuar në vrojtime, që rrisin më tej ndërgjegjësimin e përdoruesve të transportit për situatat e ardhshme të trafikut, duke përfshirë përdoruesit jo të lidhur të transportit;

4.2.3. Shërbimet e C-SIT bazuar në synime që u lejojnë automjeteve të trajtojnë skenarë kompleksë të trafikut dhe të mundësojnë drejtimin me shkallë të lartë automatizimi;

4.2.4. Shërbimet e C-SIT për infrastrukturën, që mbështesin drejtimin e automatizuar.

4.3. Specifikimet për sistemin për administrimin e kredencialeve të sigurisë të C-SIT:

4.3.1. politika e certifikatave për administrimin e certifikatave digjitale për shërbimet e C-SIT;

4.3.2. përcaktimi i rolit të autoritetit përgjegjës për politikat e certifikatave të C-SIT, administratorit të listës së besueshme të C-SIT dhe pikës së kontaktit të C-SIT;

4.3.3. politika e sigurisë për administrimin e sigurisë së informacionit në C-SIT.

SHTOJCA II
PARIMET PËR SPECIFIKIMET DHE VËNIEN NË ZBATIM TË SIT-it
(në zbatim të nenet 6, 7 dhe 9)

Miratimi i specifikimeve, nxjerrja e mandateve për standardet dhe përzgjedhja dhe vënia në zbatim e aplikimeve dhe shërbimeve të SIT-it bazohen në një vlerësim të nevojave që përfshin të gjitha grupet përkatëse të interesit dhe respekton parimet e mëposhtme. Këto masa:

a)	janë efektive	–	japin një kontribut të prekshëm në zgjidhjen e sfidave kryesore që prekin transportin rrugor në Shqipëri (p.sh. reduktimi i kongjestionit/bllokimit, adresimi i situatave të emergjencës dhe fenomeneve të motit, ulja e shkarkimeve, përmirësimi i eficiencës së energjisë, arritja e niveleve më të larta të sigurisë dhe mbrojtjes, edhe për përdoruesit e cenueshëm të rrugëve);
b)	janë ekonomike	–	optimizojnë raportin midis kostove dhe rezultateve me qëllim arritjen e objektivave;
c)	janë proporcionale	–	sigurojnë, sipas rastit, nivele të ndryshme e të arritshme për sa i përket cilësisë dhe vënies në zbatim të shërbimeve, duke marrë në konsideratë specifikat lokale, rajonale, kombëtare dhe evropiane;
ç)	mbështesin vijimësinë e shërbimeve	–	sigurojnë shërbime të pandërprera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në rrjetin transevropian dhe, kur është e mundur, në kufijtë e saj të jashtëm, në rast të vënies në zbatim të shërbimeve të SIT-it. Vazhdimësia e shërbimeve duhet të sigurohet në një nivel të përshtatur me karakteristikat e rrjeteve të transportit, që lidhin me shtetet e tjera dhe, sipas rastit, rajonet me rajonet dhe qytetet me zonat rurale;
d)	sigurojnë ndërveprueshmëri	–	sigurojnë që aplikimet, shërbimet dhe proceset bazë të biznesit të sistemeve të kenë aftësinë për të shkëmbyer të dhëna dhe për të ndarë informacione dhe njohuri në një format të standardizuar për të mundësuar ofrimin efektiv të shërbimeve të SIT-it;
dh)	mbështesin përputhshmërinë me versione më të vjetra	–	sigurojnë, kur kjo është e justifikuar, aftësinë e sistemeve të SIT-it për të punuar me sisteme ekzistuese që ndajnë një qëllim të përbashkët, pa penguar zhvillimin e teknologjive të reja dhe duke mbështetur, sipas rastit, bashkëveprimin me teknologjitë e reja ose kalimin drejt këtyre teknologjive;
e)	respektojnë infrastrukturën kombëtare ekzistuese dhe karakteristikat e rrjetit	–	marrin në konsideratë ndryshimet e qenësishme në karakteristikat e rrjetit të transportit, veçanërisht në lidhje me vëllimet e trafikut, kushtet meteorologjike në rrugë dhe specifikat e infrastrukturave;
ë)	nxisin aksesin e barabartë	–	nuk pengojnë apo diskriminojnë aksesin e përdoruesve të cenueshëm të rrugëve në aplikimet dhe shërbimet e SIT. Janë, sipas rastit, të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me kërkesat e aksesueshmërisë për personat me paaftësi në produkte dhe shërbime, kur aplikimet dhe shërbimet e SIT-it kanë për qëllim të ndërlidhin ose t'u japin informacion përdoruesve të SIT-it me aftësi të kufizuara; janë të lehta për përdorim nga persona me njohuri digjitale të kufizuara;
f)	mbështesin maturimin	–	demonstrojnë, pas një vlerësimi të përshtatshëm të rrezikut që përfshin, sipas rastit, testime të kryera në kushte reale për prodhuesit e automjeteve dhe pajisjeve, dhe ofruesit e infrastrukturës, qëndrueshmërinë e sistemeve novatore të SIT-it, përmes një niveli të mjaftueshëm të zhvillimit teknik dhe shfrytëzimit operacional;
g)	ofrojnë të dhëna cilësore lidhur me kohën dhe vendndodhjen	–	sigurojnë të paktën përputhshmërinë e aplikimeve dhe shërbimeve të SIT-it që bazohen te të dhënat lidhur me kohën dhe vendndodhjen me shërbimet e navigimit të ofruara nga Galileo, duke përfshirë Autentifikimin e Mesazheve të Navigimit të Shërbimit të Hapur dhe shërbime të tjera të Galileos, të tilla si Shërbimi me Saktësi të Lartë, kur ky shërbim është i disponueshëm, si dhe me sistemet e Shërbimit Evropian të Mbivendosjes së Navigimit Gjeostacionar (EGNOS). Sipas rastit, sigurojnë që aplikimet dhe shërbimet e SIT-it, që bazohen te të dhënat e vrojtimit të Tokës të përdorin të dhënat, informacionet ose shërbimet e Copernicus. Krahas të dhënave të Copernicus, mund të përdoren edhe të dhëna dhe shërbime të tjera;
gj)	lehtësojnë intermodalitetin	–	marrin në konsideratë koordinimin e mënyrave të ndryshme të transportit, sipas rastit, gjatë vënies në zbatim të SIT-it;
h)	respektojnë koherencën	–	marrin në konsideratë rregullat, politikat dhe aktivitetet ekzistuese të Republikës së Shqipërisë që kanë të bëjnë me fushën e SIT-it, veçanërisht në fushën e standardizimit dhe, për specifikat, parimin e neutralitetit teknologjik, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
i)	ofrojnë transparencë dhe besim	–	ofrojnë transparencë, si për shembull, duke siguruar transparencën në klasifikim, edhe për sa u përket ndikimeve në mjedis, kur u propozojnë klientëve opsione lëvizshmërie.

SHTOJCA III
LISTA E LLOJEVE TË TË DHËNAVE

Lloji i të dhënave	Mbulimi gjeografik	Data e përmendur në nenin 8, pika 2	Data e përmendur në nenin 8, pika 3
1. Të dhënat në lidhje me ofrimin e shërbimeve të informacionit mbi trafikun rrugor dhe të navigimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (sikurse përmenden në shtojcën I, Fusha prioritare I, paragrafët 1.2, 1.3):			
1.1. Kategoria: Rregulloret statike dhe dinamike të trafikut, sipas rastit, në lidhje me:			
Nënkategoria: - kushtet e aksesit për tunelet; - kushtet e aksesit për urat; - kufijtë e shpejtësisë; - ndalimet e parakalimit për automjetet e rënda; - kufizimet e peshës/gjatësisë/gjerësisë/lartësisë.	Rrjeti kryesor transevropian për rrugët.	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2027
	Rrjeti gjithëpërfshirës transevropian për rrugët, autostradat e tjera dhe segmentet e rrugëve kryesore, ku mesatarja vjetore e trafikut ditor është mbi 8 500 automjete dhe të gjitha rrugët në qytetet në qendër të secilës nyjë urbane, sikurse përcaktuar në nenin 3, shkronja "p" të urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, "Për zbatimin e rregullores, 'Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit'", dhe sikurse listohen në dokumentin përkatës, duke përfshirë edhe rrugët e administruara nga qytetet.	31 dhjetor 2026	31 dhjetor 2028
Nënkategoria: rrugët me një drejtim	Infrastruktura rrugore në qytetet në qendër të secilës nyjë urbane sipas përkufizimit në nenin 3, shkronja "p" të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, "Për zbatimin e rregullores 'Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit'".	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2027
Nënkategoria: rregulloret e transportit të mallrave	Infrastruktura rrugore në qytetet në qendër të secilës nyjë urbane, sipas përkufizimit në nenin 3, germa "p" të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, "Për zbatimin e rregullores 'Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit'".	31 dhjetor 2026	Afati do të përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin.
Nënkategoria: - drejtimi i qarkullimit në korsitë me dy drejtime.	Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët, autostradat e tjera dhe segmentet e rrugëve kryesore, ku mesatarja vjetore e trafikut ditor është mbi 8 500 automjete, dhe të gjitha rrugët në qytetet në qendër të secilës nyjë urbane, sikurse përcaktohen në nenin 3, germa "p" të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, "Për zbatimin e rregullores 'Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit'", dhe sikurse listohen në dokumentin përkatës, duke përfshirë edhe rrugët e administruara nga qytetet.	31 dhjetor 2026	Afati do të përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin.
Nënkategoria: planet e qarkullimit rrugor	Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët, autostradat e tjera dhe segmentet e rrugëve kryesore, ku mesatarja vjetore e trafikut ditor është mbi 8 500 automjete, dhe të gjitha rrugët në qytetet në qendër të secilës nyjë urbane, sikurse përcaktohen në nenin 3, germa "p" të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, "Për zbatimin e rregullores 'Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit'", dhe sikurse listohen në dokumentin përkatës, duke përfshirë edhe rrugët e administruara nga qytetet.	31 dhjetor 2028	Afati do të përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin.
Nënkategoria: kufizimet e përhershme të aksesit	Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët, autostradat e tjera dhe segmentet e rrugëve kryesore, ku mesatarja vjetore e trafikut ditor është mbi 8 500 automjete, dhe të gjitha rrugët në qytetet në qendër të secilës nyjë urbane, sikurse	31 dhjetor 2026	Afati do të përcaktohet nga ministri përgjegjës. për transportin.

	përcaktohen në nenin 3, germa "p" të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, "Për zbatimin e rregullores 'Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit'", dhe sikurse listohen në dokumentin përkatës, duke përfshirë edhe rrugët e administruara nga qytetet.		
Nënkategoria: - kufijtë e kufizimeve, ndalimeve ose detyrimeve me vlefshmëri zonale, statusi aktual i aksesit dhe kushtet për qarkullimin në zonat e trafikut të rregulluara.	Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët, autostradat e tjera dhe segmentet e rrugëve kryesore, ku mesatarja vjetore e trafikut ditor është mbi 8 500 automjete, dhe të gjitha rrugët në qytetet në qendër të secilës nyjë urbane, sikurse përcaktohen në nenin 3, germa "p" të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, "Për zbatimin e Rregullores 'Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit'", dhe sikurse listohen në dokumentin përkatës, duke përfshirë edhe rrugët e administruara nga qytetet.	31 dhjetor 2026	Afati do të përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin.
1.2. Llojet e të dhënave mbi gjendjen e rrjetit:			
Nënkategoria: - bllokimet e rrugëve; - bllokimet e korsive; - punimet në rrugë.	Rrjeti kryesor transevropian për rrugët	31 dhjetor 2025	Nuk aplikohet (shënimi 1)[2]
	Rrjeti gjithëpërfshirës transevropian për rrugët	31 dhjetor 2026	Nuk aplikohet (shënimi 1)
Nënkategoria: - masat e përkohshme të menaxhimit të trafikut.	Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët	31 dhjetor 2028	Nuk aplikohet (shënimi 1)
2. Të dhënat në lidhje me shërbimet e informacionit dhe të rezervimit për vende parkimi të sigurta për kamionët dhe mjetet për përdorim tregtar (sikurse përmenden në shtojcën I, Fusha prioritare III, paragrafi 3.2):			
Kategoria: të dhënat statike Nënkategoria: - të dhënat statike në lidhje me zonat e parkimit; - informacioni mbi sigurinë dhe pajisjet e zonës së parkimit.	Rrjeti kryesor transevropian për rrugët	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2026
	Rrjeti gjithëpërfshirës transevropian për rrugët	31 dhjetor 2026	31 dhjetor 2027
Kategoria: të dhënat dinamike Nënkategoria: - të dhënat dinamike mbi disponueshmërinë e vendeve të parkimit, duke përfshirë të dhënat mbi faktin se një zonë parkimi është plotësisht e zënë apo e mbyllur ose numrin e vendeve të lira në dispozicion.	Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët.	31 dhjetor 2027	Nuk aplikohet (shënimi 1)
3. Të dhënat mbi ngjarjet ose kushtet e konstatuara të lidhura me informacionin minimal universal mbi trafikun në lidhje me sigurinë në rrugë (sikurse përmenden në shtojcën I, Fusha prioritare III, paragrafi 3.3):			
Kategoria: të dhënat dinamike Nënkategoria: - rrugë përkohësisht e rrëshqitshme; - kafshë, njerëz, pengesa, mbeturina në rrugë; - zonë e pambrojtur aksidenti - punime afatshkurtra në rrugë - mjet që po qarkullon kundërvajtje; - bllokim i pamenaxhuar i një rruge.	Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët dhe autostradat e tjera që nuk përfshihen në atë rrjet.	31 dhjetor 2025	Nuk aplikohet (shënimi 1)
Nënkategoria: - shikueshmëri e reduktuar; - kushte meteorologjike të jashtëzakonshme.	Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët dhe autostradat e tjera që nuk përfshihen në atë rrjet.	31 dhjetor 2026	Nuk aplikohet (shënimi 1)

[2] SHËNIM 1. Nuk aplikohet: asnjë detyrim për të vënë në dispozicion të dhëna të krijuara apo të përditësuara përpara datës së përcaktuar në kolonën e tretë të kësaj shtojce në përputhje me nenin 8, pikat 1–5.

4. Të dhënat statike mbi trafikun multimodal për shërbimet e informacionit mbi udhëtimet multimodale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (sikurse përmenden në shtojcën I, Fusha prioritare I, paragrafët 1.1 dhe 1.3):			
Kategoria Vendndodhja e nyjave të identifikuara të aksesit për të gjitha mënyrat e planifikuara të transportit, duke përfshirë informacionin mbi aksesueshmërinë e nyjave dhe rrugëve të aksesit brenda një pike shkëmbimi (si p.sh. prania e ashensorëve, shkallëve lëvizëse).	Nyjat urbane sikurse përkufizohen në nenin 3, germa "p" të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 196, datë 9.7.2020, "Për zbatimin e rregullores "Për udhëzimet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e rrjetit transevropian të transportit", dhe sikurse listohen në dokumentin përkatës, duke përfshirë edhe rrugët e administruara nga qytetet.	31 dhjetor 2026	Afati do të përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin.
	Rrjeti rrugor kombëtar të Republikës së Shqipërisë, që administrohet nga ARRSH/Koncesionarët.	31 dhjetor 2028	Afati do të përcaktohet nga ministri përgjegjës për transportin.

SHTOJCA IV
LISTA E SHËRBIMEVE TË SIT-it

Shërbimi	Mbulimi gjeografik	Data
Shërbimi i informacionit universal minimal mbi trafikun, në lidhje me sigurinë rrugore, sikurse përmendet në shtojcën I, fusha prioritare III, paragrafi 3.3.	Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët	31 dhjetor 2026

SHTOJCA V
FORMATI PËR RAPORTIN FILLESTAR DHE RAPORTET E PËRPARIMIT RAPORTI MBI ZBATIMIN E KËTIJ UDHËZIMI PËR VITIN 20_ _

SHQIPËRIA
TË DHËNAT

Përmbajtja

1. **Hyrje**

1.1. Përmbledhje e përgjithshme e aktiviteteve dhe projekteve kombëtare

1.2. Përparimi i përgjithshëm që nga [viti i raportit të mëparshëm]

1.3. Informacioni i kontaktit

2. **Projektet, aktivitetet dhe iniciativat kryesore**

2.1. Fusha prioritare I. *Shërbimet SIT për informacionin dhe lëvizshmërinë*

2.1.1. Përshkrimi i aktiviteteve dhe projekteve kombëtare kryesore;

2.1.2. Përparimi që nga [viti i raportit të mëparshëm];

2.1.3. Udhëzimi i ministrit përgjegjës për transportin për ofrimin e shërbimeve të informacionit të udhëtimit multimodal në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (veprimi prioritar a);

2.1.4. Detyrimi për raportim sipas udhëzimit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 12, datë 30.12.2024, "Mbi ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale" (veprimi prioritar b).

2.2. Fusha prioritare II. *Shërbimet SIT për udhëtimin, transportin dhe menaxhimin e trafikut*

2.2.1. Përshkrimi i aktiviteteve dhe projekteve kombëtare kryesore:

2.2.2. Përparimi që nga [viti i raportit të mëparshëm];

2.3. Fusha prioritare III. *Shërbimet SIT për sigurinë dhe mbrojtjen rrugore;*

2.3.1. Përshkrimi i aktiviteteve dhe projekteve kombëtare kryesore;

2.3.2. Përparimi që nga [viti i raportit të mëparshëm]:

2.3.3. 112 eCall (veprimi prioritar d – Udhëzimi i ministrit përgjegjës për transportin për shërbimin telefonik elektronik (eCall) ndërveprues);

2.3.4. Detyrimi për raportim sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin mbi të dhënat dhe procedurat për ofrimin, kur është e mundur, të informacionit rrugor minimal universal për sigurinë rrugore, pa pagesë për përdoruesit (veprimi prioritar c);

2.3.5. Detyrimi për raportim sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin për ofrimin e shërbimeve të informacionit për vende të sigurta dhe të mbrojtura parkimi për kamionë dhe automjete tregtare (veprimi prioritar e);

2.4. Fusha prioritare IV. *Shërbimet SIT për lëvizshmëri bashkëpunuese, të lidhur dhe të automatizuar;*

2.4.1. Përshkrimi i aktiviteteve dhe projekteve kombëtare kryesore;

2.4.2. Përparimi që nga [viti i raportit të mëparshëm];

2.5. Disponueshmëria dhe aksesueshmëria përmes Pikave Kombëtare të Aksesit (NAPs) e llojeve të të dhënave të listuara në shtojcën III të këtij udhëzimi:

2.5.1. Të dhëna që lidhen me ofrimin e informacionit rrugor dhe shërbimeve të navigimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

2.5.2. Të dhëna që lidhen me shërbimet e informacionit dhe rezervimit për vende të sigurta dhe të mbrojtura parkimi për kamionë dhe automjete tregtare;

2.5.3. Të dhëna për ngjarje ose kushte të identifikuara që lidhen me sigurinë rrugore dhe informacionin minimal universal të trafikut për sigurinë rrugore;

2.5.4. Të dhëna statike multimodale të trafikut për shërbimet e informacionit të udhëtimi multimodal në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

2.6. Disponueshmëria e shërbimeve të listuara në shtojcën IV të këtij udhëzimi;

2.6.1. Shërbimet e informacionit rrugor minimal universal të trafikut që lidhen me sigurinë rrugore;

2.7. Iniciativa/pika të tjera kryesore;

2.7.1. Përshkrimi i iniciativave/pikave dhe projekteve të tjera kombëtare që nuk mbulohen në fushat prioritare 1 deri 4;

2.7.2. Përparimi që nga [viti i raportit të mëparshëm].

3.**Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI)**

3.1. KPI të zbatimit:

3.1.1. Infrastruktura/pajisje për mbledhjen e informacionit (KPI rrugor);

3.1.2. Zbulimi i incidenteve (KPI rrugor);

3.1.3. Masat e menaxhimit të trafikut dhe kontrollit të trafikut (KPI rrugor);

3.1.4. Shërbime dhe aplikacione bashkëpunuese SIT (KPI rrugor);

3.1.5. Informacioni për trafikun në kohë reale (KPI rrugor);

3.1.6. Informacioni i udhëtimit dinamik (KPI multimodal);

3.1.7. Informacion për transportin e mallrave (multimodal nëse është e mundur ose KPI rrugor);

3.2. KPI të përfitimeve:

3.2.1. Ndryshimi në kohën e udhëtimit (KPI rrugor);

3.2.2. Ndryshimi në numrin e aksidenteve rrugore që përfundojnë me vdekje ose plagosje (KPI rrugor);

3.2.3. Ndryshimi në emetimet e CO_2 nga trafiku (KPI rrugor);

3.3. KPI financiare.

1. HYRJE

1.1 Përmbledhje e përgjithshme e aktiviteteve dhe projekteve kombëtare

Duke përfshirë legjislacionin ose strategjitë kombëtare për Shërbimet Inteligjente të Transportit (SIT), ose të dyja.

1.2 Përparimi i përgjithshëm që nga [viti i raportit të mëparshëm]

Përmbledhje e përparimit që nga raporti i mëparshëm:

1.3. Informacioni i kontaktit

2. PROJEKTET, AKTIVITETET DHE INICIATIVAT KRYESORE

2.1. Fusha prioritare I. Shërbime SIT për informacionin dhe lëvizshmërinë

2.1.1. *Përshkrimi i aktiviteteve dhe projekteve kombëtare kryesore*

Përshkrimi i iniciativave përkatëse, objektivat e tyre, afatet kohore, momentet kyçe, burimet, pala/palët drejtuese dhe statusi:

2.1.2. *Përparimi që nga [viti i raportit të mëparshëm]*

Përshkrimi i përparimit në këtë fushë që nga [viti i raportit të mëparshëm]:

2.1.3. *Udhëzimi i ministrit përgjegjës për transportin për ofrimin e shërbimeve të informacionit për udhëtimin multimodal në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (veprimi prioritar a)*

Përparimi i bërë në lidhje me aksesueshmërinë, shkëmbimin dhe ripërdorimin e tipave të të dhënave të udhëtimit dhe trafikut të përcaktuara në kategoritë e të dhënave për ofrimin e shërbimeve të informacionit për udhëtimin multimodal:

Shtrirja gjeografike e të dhënave të përcaktuara në kategoritë e të dhënave për ofrimin e

shërbimeve të informacionit për udhëtimin multimodal, të aksesueshme përmes pikës kombëtare të aksesit dhe cilësia e tyre, duke përfshirë kriteret e përdorura për përcaktimin e cilësisë dhe mjetet për monitorimin e saj:

Lidhja e shërbimeve të informacionit të udhëtimit:

Rezultatet e vlerësimit të përputhshmërisë sipas rregullave për vlerësimin e përputhshmërisë për ofrimin e shërbimeve të informacionit për udhëtimin multimodal:

Nëse ka, përshkrimi i ndryshimeve në pikën kombëtare ose të përbashkët të aksesit:

2.1.4. ***Detyrimi për raportim sipas udhëzimit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 12, datë 30.12.2024, "Mbi ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale" (veprimi prioritar b)***

Përparimi në lidhje me aksesueshmërinë, shkëmbimin dhe ripërdorimin e tipave të të dhënave të përcaktuara në shtojcën e udhëzimit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 12, datë 30.12.2024, "Mbi ofrimin e shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale":

Shtrirja gjeografike e të dhënave të aksesueshme përmes Pikës Kombëtare të Aksesit, ndryshimet në rrjetin rrugor kryesor dhe përmbajtja e të dhënave të shërbimeve të informacionit të trafikut në kohë reale, si dhe cilësia e tyre, përfshirë kriteret për përcaktimin e cilësisë dhe mjetet për monitorimin e saj:

Rezultatet e vlerësimit të përputhshmërisë sipas nenit 13 me kërkesat e neneve 3 deri 12:

2.2. Fusha prioritare II. Shërbime SIT për udhëtimin, transportin dhe menaxhimin e trafikut

2.2.1. ***Përshkrimi i aktiviteteve dhe projekteve kombëtare kryesore***

Përshkrimi i iniciativave përkatëse, objektivat, afatet kohore, momentet kyçe, burimet, pala/palët drejtuese dhe statusi:

2.2.2. ***Përparimi që nga [viti i raportit të mëparshëm]***

Përshkrimi i përparimit në këtë fushë që nga [viti i raportit të mëparshëm]:

2.3. Fusha prioritare III. Shërbime SIT për sigurinë dhe mbrojtjen rrugore

2.3.1. ***Përshkrimi i aktiviteteve dhe projekteve kombëtare kryesore***

Përshkrim i iniciativave përkatëse, objektivat, afatet kohore, momentet kyçe, burimet, pala/palët drejtuese dhe statusi:

2.3.2. ***Përparimi që nga [viti i raportit të mëparshëm]***

Përshkrim i përparimit në këtë fushë që nga [viti i raportit të mëparshëm]:

2.3.3. ***112 eCall (veprimi prioritar d – Udhëzimi i ministrit përgjegjës për transportin për shërbimin telefonik elektronik (eCall) ndërveprues)***

Informacion mbi çdo ndryshim në infrastrukturën kombëtare të qendrave PSAP për eCall dhe autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërisë së funksionimit të PSAP për eCall:

Informacion shtesë:

2.3.4. ***Detyrimi për raportim sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin për të dhënat dhe procedurat për ofrimin, kur është e mundur, të informacionit minimal universal të trafikut për sigurinë rrugore pa pagesë për përdoruesit (veprimi prioritar c)***

Përparimi në zbatimin e shërbimit të informacionit, përfshirë kriteret e përdorura për përcaktimin e cilësisë së tij dhe mjetet për monitorim e cilësisë së tij:

Rezultatet e vlerësimit të përputhshmërisë me kërkesat e të udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin për të dhënat dhe procedurat për ofrimin, kur është e mundur, të informacionit minimal universal të trafikut për sigurinë rrugore pa pagesë për përdoruesit:

Nëse ka, përshkrimi i ndryshimeve në pikën kombëtare të aksesit:

Informacion shtesë (p.sh. burimet e të dhënave të përdorura për ofrimin e informacionit të trafikut për sigurinë rrugore):

2.3.5. ***Detyrimi për raportim sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin për ofrimin e shërbimeve të informacionit për vende të sigurta dhe të mbrojtura parkimi për kamionë dhe automjete tregtare (veprimi prioritare)***

Numri i pikave të ndryshme të parkimit dhe hapësirave për parkim në territorin e Republikës së Shqipërisë:

Përqindja e vendeve të parkimit të regjistruara në shërbimin e informacionit:

Përqindja e vendeve të parkimit që ofrojnë informacion dinamik për disponueshmërinë e hapësirave dhe zonave prioritare:

2.4 Fusha prioritare IV. Shërbime SIT për lëvizshmëri bashkëpunuese, të lidhur dhe të automatizuar:

2.4.1. *Përshkrimi i aktiviteteve dhe projekteve kombëtare kryesore*

Përshkrim i iniciativave përkatëse, objektivat, afatet kohore, momentet kyçe, burimet, pala/palët drejtuese dhe statusi: në veçanti, jepni informacion mbi iniciativat për vendosjen e C-SIT dhe specifikimet teknike të tyre.

2.4.2. *Përparimi që nga [viti i raportit të mëparshëm]*

Përshkrim i përparimit në këtë fushë që nga [viti i raportit të mëparshëm]:

2.5. Disponueshmëria dhe aksesueshmëria përmes Pikave Kombëtare të Aksesit (NAPs) e llojeve të të dhënave të listuara në shtojcën III të këtij udhëzimi

Parimet e përllogaritjes:

** Për informacionin statik: bazohet në gjatësinë e pjesëtuar me gjatësisë totale në kilometra. Gjatësia totale është ajo e rrjetit në të cilin ekziston informacioni bazë, p.sh. për të cilin zbatohen kufizimet e shpejtësisë (pothuajse) kudo, ndërsa kushtet e aksesit për tunelet vlejnë vetëm për seksionet e tunelit (pra gjatësinë e tyre).*

*** Për informacionin dinamik/të përkohshëm: disponueshmëria e të dhënave i referohet aftësisë për t'i bërë ato të disponueshme dhe të aksesueshme në format të lexueshëm nga makina në një përqindje të caktuar të rrjetit, sa herë që informacioni bazë ekziston/shfaqet, duke u bazuar në gjatësinë e rrjetit me këtë kapacitet të pjesëtuar me gjatësisë totale në kilometra.*

2.5.1. *Të dhëna që lidhen me ofrimin e informacionit të trafikut rrugor dhe shërbimeve të navigimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë*

Lloji i të dhënave	Mbulimi gjeografik	% e shtrirjes gjeografike ku tipi i të dhënës është i disponueshëm		Komente
1. Të dhëna që lidhen me ofrimin e informacionit të trafikut rrugor dhe shërbimeve të navigimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë:				
1.1 Kategoria: Rregullore trafiku statike dhe dinamike, kur është e zbatueshme, që lidhen me:				
1.1.1 Nënkategori: - kushte aksesimi për tunelet - kushte aksesimi për urat - kufizime shpejtësie - ndalim parakalimi i automjeteve të rënda të mallrave - kufizime në peshë/gjatësi/gjerësi/lartësi	Rrjeti kryesor transevropian i rrugëve	kushtet e aksesit për tunelet*	% *[Shënim. Nëse është më e përshtatshme, ekziston mundësia për të dhënë numrin dhe përqindjen e tuneleve.]*	
		kushtet e aksesit për urat*	% *[Shënim. nëse është më e përshtatshme, ekziston mundësia për të dhënë numrin dhe përqindjen e urave.]*	
		kufizimet e shpejtësisë*	%	
		ndalimet e parakalimit të automjeteve të rënda të mallrave*	%	
		kufizimet e peshës/gjatësisë/gjerësisë /lartësisë*	%	
	Rrjeti gjithëpërfshirës transevropian i rrugëve, autostradat e tjera dhe segmentet e rrugëve kryesore, ku trafiku mesatar ditor vjetor total është më shumë se 8 500 automjete, si dhe të gjitha rrugët në qytetet që janë në qendër të secilës nyjë urbane (nëse është e aplikueshme, i kufizuar në më shumë se 7 000 automjete/ditë).	kushtet e aksesit për tunelet*	%	
		kushtet e aksesit për urat*	%	
		kufizimet e shpejtësisë**	%	
		ndalimet e parakalimit të automjeteve të rënda të mallrave*	%	
		kufizimet e peshës/gjatësisë/gjerësisë /lartësisë*	%	
Nënkategoria: - rrugë njëkalimshe	*Infrastruktura rrugore në qytetet në qendër të secilës nyjë urbane*	*rrugë njëkalimshe**	% *[Shënim. Nëse vlerësohet e rëndësishme, ekziston*	

			mundësia për të dhënë gjithashtu numrin dhe përqindjen e qyteteve që mund të furnizojnë të tilla të dhëna.]	
Nënkategori: - rregullat për shpërndarjen e mallrave	*Infrastruktura rrugore në qytetet në qendër të secilës nyjë urbane*	rregullat për shpërndarjen e mallrave*	*%* *[Shënim. Nëse vlerësohet e rëndësishme, ekziston mundësia për të dhënë gjithashtu numrin dhe përqindjen e qyteteve që mund të furnizojnë të tilla të dhëna.]*	
Nënkategoria: - drejtimi i udhëtimit në korsitë me ndryshim të drejtimit të lëvizjes	*Rrjeti kryesor dhe ai gjithëpërfshirës transevropian i rrugëve, autostradat e tjera dhe pjesët e rrugëve kryesore me më shumë se 8 500 automjete në ditë mesatarisht në vit, si dhe të gjitha rrugët në qytetet qendrore të nyjave urbane (nëse duhet, mbi 7 000 automjete në ditë).*	drejtimi i udhëtimit në korsitë me ndryshim të drejtimit të lëvizjes*	%	
Nënkategori: - planet e qarkullimit të trafikut	*Rrjeti kryesor dhe ai gjithëpërfshirës transevropian i rrugëve, autostradat e tjera dhe pjesët e rrugëve kryesore me më shumë se 8 500 automjete në ditë mesatarisht në vit, si dhe të gjitha rrugët në qytetet qendrore të nyjave urbane (nëse duhet, mbi 7 000 automjete në ditë).*	planet e qarkullimit të trafikut*	*% [Shënim. nëse është e pamundur të llogaritet gjatësia e rrjetit, ekziston mundësia për të dhënë numrin dhe përqindjen e planeve të qarkullimit të trafikut.]*	
Nënkategori: - kufizime të përhershme të aksesit	*Rrjeti kryesor dhe ai gjithëpërfshirës transevropian i rrugëve, autostradat e tjera dhe pjesët e rrugëve kryesore me më shumë se 8 500 automjete në ditë mesatarisht në vit, si dhe të gjitha rrugët në qytetet qendrore të nyjave urbane (nëse duhet, mbi 7 000 automjete në ditë).*	kufizime të përhershme të aksesit*	%	
Nënkategoria: - kufijtë e zonave ku ka kufizime, ndalime ose detyrime për qarkullimin, si dhe statusi aktual i aksesit dhe kushtet për qarkullimin në këto zona trafiku të rregulluara.	*Rrjeti kryesor dhe ai gjithëpërfshirës transevropian i rrugëve, autostradat e tjera dhe pjesët e rrugëve kryesore me më shumë se 8 500 automjete në ditë mesatarisht në vit, si dhe të gjitha rrugët në qytetet qendrore të nyjave urbane (nëse duhet, mbi 7 000 automjete në ditë).*	kufijtë e zonave ku ka kufizime, ndalime ose detyrime për qarkullimin, si dhe statusi aktual i aksesit dhe kushtet për qarkullimin në këto zona trafiku të rregulluara*	*%* *[Shënim. Nëse është e pamundur të llogaritet gjatësia e rrjetit, ekziston mundësia për të dhënë numrin dhe përqindjen e kufijve të kufizimeve, ndalimeve etj.]*	
1.2 Llojet e të dhënave mbi gjendjen e rrjetit:				
Nënkategoria: - mbylljet e rrugës; - mbylljet e korsisë; - punime rrugore.	*Rrjeti kryesor transevropian i rrugëve*	mbyllje rrugësh**	%	
		mbyllje korsish**	%	
		punime në rrugë**	%	
	Rrjeti gjithëpërfshirës transevropian i rrugëve	mbyllje rrugësh**	%	
		mbyllje korsish**	%	
		punime në rrugë**	%	
Nënkategoria: - masa të përkohshme për menaxhimin e trafikut.	*Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian i rrugëve*	masa të përkohshme për menaxhimin e trafikut**	%	

2.5.2. Të dhënat lidhur me shërbimet e informacionit dhe rezervimit për vendparkime të sigurta dhe të besueshme për kamionë dhe automjete tregtare

Lloji i të dhënave	Mbulimi gjeografik	% e vendeve të parkimit për të cilat janë të disponueshme të dhënat		Komente
2. Të dhëna që lidhen me shërbimet për informacion dhe rezervim vende parkimi të sigurta dhe të mbrojtura për kamionët dhe automjetet tregtare:				
Kategoria: të dhëna statike *Nënkategoria:* - të dhëna statike lidhur me zonat e parkimit; - informacione për sigurinë dhe pajisjet e zonës së parkimit.	*Rrjeti kryesor transevropian i rrugëve*	të dhëna statike lidhur me zonat e parkimit	%	
		informacione për sigurinë dhe pajisjet e zonës së parkimit	%	
	Rrjeti gjithëpërfshirës transevropian i rrugëve	të dhëna statike lidhur me zonat e parkimit	%	
		informacione për sigurinë dhe pajisjet e zonës së parkimit	%	
Kategoria: të dhëna dinamike *Nënkategoria:* - të dhëna dinamike për disponueshmërinë e vendeve të parkimit, duke përfshirë nëse një vendparkim është: plot, i mbyllur ose numrin e vendeve të lira që janë në dispozicion.	*Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian i rrugëve*	të dhëna dinamike për disponueshmërinë e vendeve të parkimit, duke përfshirë nëse një parkim është: plot, i mbyllur ose numri i vendeve të lira të cilat janë në dispozicion.	%	

2.5.3. Të dhëna mbi ngjarjet ose kushtet e zbuluara që lidhen me sigurinë rrugore, në lidhje me informacionin minimal universal të trafikut mbi sigurinë rrugore.

Lloji i të dhënave	Mbulimi gjeografik	% e shtrirjes gjeografike ku tipi i të dhënave është i disponueshëm		Komente
3. Të dhëna mbi ngjarjet dhe kushtet e zbuluara që lidhen me sigurinë rrugore që lidhen informacionin minimal universal të trafikut për sigurinë rrugore:				
Kategoria: të dhëna dinamike *Nënkategoria:* - rrugë përkohësisht e rrëshqitshme; - kafshë, njerëz, pengesa, mbeturina në rrugë; - zonë aksidenti e pambrojtur; - punime afatshkurtra në rrugë; - drejtues mjeti në kah të gabuar; - bllokim i paparashikuar i rrugës.	*Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët dhe autostradat e tjera që nuk përfshihen në atë rrjet.*	rrugë përkohësisht e rrëshqitshme**	%	
		kafshë, njerëz, pengesa, mbeturina në rrugë**	%	
		zonë aksidenti e pambrojtur**	%	
		punime afatshkurtra në rrugë**	%	
		drejtues mjeti në kah të gabuar**	%	
		bllokim i paparashikuar i rrugës**	%	
Nënkategoria: - shikueshmëri e reduktuar; - kushte të jashtëzakonshme moti.	*Rrjeti kryesor dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët, si dhe autostradat e tjera që nuk janë të përfshira në këtë rrjet.*	shikueshmëri e reduktuar**	%	
		kushte të jashtëzakonshme moti**	%	

2.5.4. Të dhëna statike të trafikut multimodal për shërbimet e informacionit të udhëtimit multimodal në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

***Kur është e mundur, jepen të dhëna sipas mënyrave të transportit të planifikuar, të përmendura në shtojcën e udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin për shërbimet e informacionit të udhëtimit multimodal (të tilla si: ajror, hekurudhor përfshirë hekurudhën me shpejtësi të lartë, hekurudhën konvencionale, hekurudhën e lehtë, teleferikët, autobusët ndërqytetës, detar përfshirë tragetet, ujërat e brendshme, metrotë, tramvajet, autobusët, trolejbusët).

Lloji i të dhënave	Mbulimi gjeografik	% e nyjave ku janë të disponueshme të dhënat për mënyrën e transportit të planifikuar		Komente
4. Të dhëna statike të trafikut multimodal për shërbimet e informacionit të udhëtimit multimodal për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë:				
Kategoria Vendndodhja e nyjave të aksesit të identifikuara për të gjitha mënyrat e transportit të planifikuar, përfshirë informacionin mbi aksesueshmërinë e nyjave dhe shtigjeve të aksesit brenda një ndërrimi (p.sh. ekzistenca e ashensorëve, shkallëve lëvizëse).	*Nyjat urbane sikurse përcaktuar në legjislacionin shqiptar, duke përfshirë ato të administruara nga qytetet*	Vendndodhja e nyjave të aksesit të identifikuara për të gjitha mënyrat e transportit të planifikuar, përfshirë informacionin mbi aksesueshmërinë e nyjave dhe shtigjeve të aksesit brenda një ndërrimi (p.sh. ekzistenca e ashensorëve, shkallëve lëvizëse)	%	
	I gjithë rrjeti i transportit i Bashkimit	Vendndodhja e nyjave të aksesit të identifikuara për të gjitha mënyrat e transportit të planifikuar, përfshirë informacionin mbi aksesueshmërinë e nyjave dhe shtigjeve të aksesit brenda një ndërrimi (p.sh. ekzistenca e ashensorëve, shkallëve lëvizëse)	%	

6. Disponueshmëria e shërbimeve të listuara në shtojcën IV të këtij udhëzimi

2.6.1. *Shërbimet minimale universale të informacionit për trafikun lidhur me sigurinë rrugore*

Shërbimi	Mbulimi gjeografik	% e shtrirjes gjeografike të mbuluar
Shërbimi i informacionit minimal universal për trafikun lidhur me sigurinë rrugore (SRTI)	*Rrjeti bazë dhe gjithëpërfshirës transevropian për rrugët*	%

2.7. Iniciativa/pika kryesore të tjera

2.7.1. *Përshkrimi i iniciativave/pikave kryesore dhe projekteve të tjera kombëtare që nuk përfshihen në fushat prioritare 1 deri në 4:*

Përshkrimi i iniciativave përkatëse, objektivi i tyre, afati kohor, fazat kryesore, burimet, aktori/aktorët kryesorë dhe statusi i tyre:

2.7.2. *Përparimi që nga [viti i raportit të mëparshëm]*

Përshkrimi i përparimit në këtë fushë që nga [viti i raportit të mëparshëm]:

3. TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS (KPIs)

Treguesit KPI do të raportohen veçmas sipas tipit të rrjetit rrugor/rrjetit të transportit dhe nyjave (kur është e përshtatshme).

3.1. Treguesit KPI të zbatimit

3.1.1. *Infrastrukturat/pajisjet për mbledhjen e informacionit (KPI rrugor)*

Të dhënat duhet të jepen sipas tipit të rrjetit.

Të dhënat duhet të jepen sipas tipit të shërbimeve dhe, ku është e rëndësishme, duke bërë dallimin midis pajisjeve fikse dhe të lëvizshme.

KPI-të do të llogariten sipas tipit të rrjetit.

- Gjatësia e tipit të rrjetit rrugor/seksioneve rrugore (në km) të pajisura me infrastrukturë për mbledhjen e informacionit dhe gjatësia totale e këtij tipi rrjeti (në km):

- KPI = (kilometra të tipit të rrjetit rrugor të pajisura me infrastrukturë për mbledhjen e informacionit/kilometra total të të njëjtit tip rrjeti) × 100.

3.1.2. *Zbulimi i incidenteve (KPI rrugor)*

Të dhënat duhet të jepen sipas tipit të rrjetit.

KPI-ja do të llogaritet sipas tipit të rrjetit.

- Gjatësia e tipit të rrjetit rrugor/seksioneve rrugore (në km) të pajisura me sisteme inteligjente

transporti (SIT) për zbulimin e incidenteve dhe gjatësia totale e këtij tipi rrjeti (në km):

- KPI = (kilometra të tipit të rrjetit rrugor të pajisur me SIT për zbulimin e incidenteve/kilometra total të të njëjtit tip rrjeti) × 100.

3.1.3. *Menaxhimi i trafikut dhe masat e kontrollit të trafikut (KPI rrugor)*

Të dhënat duhet të jepen sipas tipit të rrjetit.

KPI-ja do të llogaritet sipas tipit të rrjetit.

- Gjatësia e tipit të rrjetit rrugor/seksioneve rrugore (në km) të mbuluara nga masat e menaxhimit dhe kontrollit të trafikut dhe gjatësia totale e këtij tipi rrjeti (në km):

- KPI = (kilometra të tipit të rrjetit rrugor të mbuluara nga masat e menaxhimit dhe kontrollit të trafikut/kilometra total të të njëjtit tip rrjeti) × 100.

3.1.4. Shërbimet dhe aplikacionet SIT bashkëpunuese (KPI rrugor)

Të dhënat duhet të jepen sipas tipit të rrjetit.

KPI-ja do të llogaritet sipas tipit të rrjetit.

- Gjatësia e tipit të rrjetit rrugor/seksioneve rrugore (në km) të mbuluara nga shërbimet ose aplikacionet C-SIT dhe gjatësia totale e këtij tipi rrjeti (në km):

- KPI = (kilometra të tipit të rrjetit rrugor të mbuluar nga shërbimet ose aplikacionet C-SIT/kilometra total të të njëjtit tip rrjeti) × 100

3.1.5. *Informacioni në kohë reale për trafikun (KPI rrugor)*

Të dhënat duhet të jepen sipas tipit të rrjetit.

KPI-ja do të llogaritet sipas tipit të rrjetit.

- Gjatësia e tipit të rrjetit rrugor/seksioneve rrugore (në km) me ofrimin e shërbimeve të informacionit për trafikun në kohë reale dhe gjatësia totale e këtij tipi rrjeti (në km):

- KPI = (kilometra të tipit të rrjetit rrugor me ofrimin e shërbimeve të informacionit në kohë reale/kilometra total të të njëjtit tip rrjeti) × 100.

3.1.6. *Informacioni dinamik për udhëtimin (KPI multimodal)*

Të dhënat duhet të jepen sipas tipit të rrjetit/nyjës.

KPI-ja do të llogaritet sipas tipit të rrjetit/nyjës (kur është relevante); nëse është e përshtatshme, tregoni përqindjen e shërbimeve të aksesueshme për pasagjerët me lëvizshmëri, orientim dhe/ose komunikim të reduktuar.

- Gjatësia e tipit të rrjetit të transportit (në km) me ofrimin e shërbimeve të informacionit dinamik për udhëtimin dhe gjatësia totale e këtij tipi rrjeti (në km):

- Numri i nyjave të transportit (p.sh. stacione hekurudhore ose autobusësh) të mbuluara nga shërbimet e informacionit dinamik dhe numri total i të njëjtave nyja:

- KPI = (kilometra të tipit të rrjetit të transportit me ofrimin e shërbimeve të informacionit dinamik/kilometra total të të njëjtit tip rrjeti) × 100.

- KPI = (numri i nyjave të transportit me ofrimin e shërbimeve të informacionit dinamik/numri total i të njëjtave nyje) × 100.

3.1.7. *Informacioni për transportin e mallrave (KPI multimodal nëse është e mundur ose KPI rrugor)*

Të dhënat duhet të jepen sipas tipit të rrjetit/nyjës.

KPI-ja do të llogaritet sipas tipit të rrjetit/nyjës (kur është relevante); nëse është e përshtatshme, tregoni përqindjen e shërbimeve të aksesueshme për pasagjerët me lëvizshmëri, orientim dhe/ose komunikim të reduktuar.

- Gjatësia e tipit të rrjetit rrugor/seksioneve rrugore (në km) me ofrimin e shërbimeve të informacionit për mallrat dhe gjatësia totale e këtij tipi rrjeti (në km):

- Numri i nyjave të mallrave (p.sh. porte, platforma logjistike) të mbuluara nga shërbimet e informacionit për mallrat dhe numri total i të njëjtave nyja:

- KPI = (kilometra të tipit të rrjetit rrugor me ofrimin e shërbimeve të informacionit për mallrat/kilometra total të të njëjtit tip rrjeti) × 100

- KPI = (numri i nyjave të mallrave me ofrimin e shërbimeve të informacionit për mallrat/numri total i të njëjtave nyje) × 100

3.2. Treguesit KPI të përfitimeve

3.2.1. *Ndryshimi në kohën e udhëtimit (KPI rrugor)*

Të dhënat duhet të përfshijnë gjithashtu automjete/km të vozitjes për rrugën/zonën e konsideruar.

KPI = ((koha e udhëtimit para zbatimit ose përmirësimit të SIT – koha e udhëtimit pas zbatimit ose përmirësimit të SIT)/koha e udhëtimit para zbatimit ose përmirësimit të SIT) × 100.

3.2.2. *Ndryshimi në numrin e aksidenteve rrugore me pasojë vdekje ose lëndime (KPI rrugor)*

Nëse është e mundur, mund të bëhet dallimi midis aksidenteve me pasojë vdekje, plagosje të rënda ose plagosje të lehta.

Të dhënat që duhet të jepen duhet të përfshijnë gjithashtu automjete/km të vozitjes për rrugën/zonën e konsideruar.

- Numri i aksidenteve rrugore me pasojë vdekje ose plagosje para zbatimit ose përmirësimit të SIT-it:

- Numri i aksidenteve rrugore me pasojë vdekje ose plagosje pas zbatimit ose përmirësimit të SIT-it:

3.2.3. *Ndryshimi në emetimet e CO_2 nga trafiku (KPI rrugor)*

Ju lutemi specifikoni rrugët/zonat ku SIT-i është zbatuar ose përmirësuar. Gjatësia apo zona brenda së cilës llogaritet ndryshimi në emetimet e CO_2 duhet të jetë mjaft e gjatë ose e gjerë për të qenë përfaqësuese.

KPI = ((emetimet e CO_2 nga trafiku para zbatimit ose përmirësimit të SIT – emetimet e CO_2 nga trafiku pas zbatimit ose përmirësimit)/emetimet e CO_2 nga trafiku para zbatimit ose përmirësimit të SIT) × 100

3.3. Treguesit KPI financiarë

SIT përfshin çdo tip sistemi dhe shërbimi së bashku.

Investimi publik vjetor* në SIT rrugor (si % e totalit të investimeve në infrastrukturën e transportit):

Kostot vjetore publike* për operimin dhe mirëmbajtjen e SIT rrugor (në euro për kilometër të rrjetit të mbuluar):

** administratat publike ose entitetet me pronësi publike.*

Kur është e mundur, të jepen të njëjtat shifra edhe për investimet dhe kostot private.

SHTOJCË VI
TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS (KPI-të)

	Emri i KPI-së	Shtrirja gjeografike	Kronologjia
KPI-të e zbatimit	Infrastrukturat/pajisjet për mbledhjen e informacionit (KPI rrugor)	Rrjeti kryesor, i zgjeruar dhe gjithëpërfshirës TEN-T (pa nyjat urbane) + autostradat	I detyrueshëm në 2027
		Nyjat urbane nga TEN-T + rrugët parësore	E detyrueshme në 2030 (vullnetare përpara)
		I gjithë rrjeti rrugor	KPI-ja shtesë që do të jepet në mënyrë vullnetare
	Zbulimi i incidenteve (KPI rrugor)	Rrjeti kryesor, i zgjeruar dhe gjithëpërfshirës TEN-T (pa nyjat urbane) + autostradat	I detyrueshëm në 2027
		Nyjat urbane nga TEN-T + rrugët primare	E detyrueshme në 2030 (vullnetare përpara)
		I gjithë rrjeti rrugor	KPI-ja shtesë që do të jepet në mënyrë vullnetare
	Masat për menaxhimin e trafikut dhe për kontrollin e trafikut (KPI rrugor)	Rrjeti kryesor, i zgjeruar dhe gjithëpërfshirës TEN-T (pa nyjat urbane) + autostradat	I detyrueshëm në 2027
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 170, DATË 13.9.2022, PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE QË LIDHEN ME AERODROMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË[3]", I NDRYSHUAR

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të shkronjës "ç", të nenit 7 dhe pikës 10, të nenit 54, të ligjit nr. 96/2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", të ndryshuar dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian",

URDHËROJ:

1. Në rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 170, datë 13.9.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE QË LIDHEN ME AERODROMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

I. DISPOZITAT NDRYSHUESE

1. Nenet 4 dhe 5 shfuqizohen.

2. Në nenin 7, pas paragrafit 3, shtohet paragrafi 4, si më poshtë:

"4. "Dokumenti i Pranimit të Devijimit dhe Veprimit" (DPDV) i bashkangjitur certifikatës do t'i transferohet operatorit të ri të aerodromit të cilit do t'i transferohet menaxhimi i aerodromit, me kusht që të plotësohen kushtet e përmendura në paragrafët 1 dhe 3.".

3. Në aneksin I bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) pas pikës 4 shtohet pika 4/"a", si më poshtë:

"4a. "Dendësia e trafikut të aerodromit" nënkupton numrin e lëvizjeve në orën mesatare më të ngarkuar dhe është mesatarja aritmetike gjatë vitit, të numrit të lëvizjeve në orën më të ngarkuar ditore;";

b) pas pikës 19/"a" shtohet pika 19/"b", si më poshtë:

"19b "Pikë e nxehtë" nënkupton një vendndodhje në një zonë të lëvizjes së aerodromit me një historik ose rrezik të mundshëm përplasjeje ose inkursioni në pistë dhe ku është e nevojshme një vëmendje e shtuar nga pilotët ose drejtuesit e mjeteve;";

c) pika 65 zëvendësohet me sa vijon:

"65. "SNOWTAM" do të thotë një seri e posaçme NOTAM gjeneruar në një format standard, i cili siguron një raport të kushteve të

[3] Ky urdhër përafron plotësisht rregulloret e BE-së nr. 2022/2074, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 280, datë 18.10.2022, nr. 2024/894, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 894, datë 20.3.2024, nr. 2024/405, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 2024/405, datë 11.4.2024, nr. 2024/1400, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 2024/1400, Datë 24.5.2024, nr. 2025/21, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 2025/21, datë 7.3.2025 dhe pjesërisht Rregulloret nr. 2022/1645, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 248, datë 26.9.2022, nr. 2023/203, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 31, datë 2.2.2023.

sipërfaqes që njofton praninë ose ndërprerjen e kushteve të rrezikshme për shkak të borës, akullit, llucës, ngricës, ujit të ndenjur ose ujit të lidhur me dëborën, baltën, akullin ose ngricat në zonën e lëvizjes.";

ç) pika 72 zëvendësohet me sa vijon:

"72. "Kushtet e certifikatës" nënkupton të gjitha sa vijon:

- Treguesit e vendndodhjes sipas ICAO-s;
- kushtet e operimit (VFR/IFR, ditë/natë);
- operimet e avionit në pistat dimërore të përgatitura posaçërisht;
- pistën – distancat e deklaruara;
- llojet e pistës dhe afrimet e ofruara;
- kodin e referencës së aerodromit;
- fushëveprimin e operimeve të avionëve që tejkalojnë karakteristikat e certifikuara të projektimit të aerodromit;
- ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit të avionëve (po/jo);
- nivelin e mbrojtjes për shërbimet e shpëtimit dhe fikjes së zjarrit.".

4. Në aneksin II (Pjesa – ADR.AR) bëhen ndryshimet, si më poshtë:

1. në pikën ADR.AR.A.025, shkronjat "a" dhe "b" zëvendësohen, si më poshtë:

"a) Kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, Autoriteti i Aviacionit Civil do të njoftojë pa vonesë Agjencinë në rast të ndonjë problemi të rëndësishëm me zbatimin e VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dhe në çdo rast, brenda 30 ditëve nga momenti kur ka marrë dijeni për këto probleme të rëndësishme;

b) Kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë", Autoriteti i Aviacionit Civil do të vërë në dispozicion të Agjencisë informacionet e rëndësishme që lidhen me sigurinë në operim, të cilat rrjedhin nga raportet e ngjarjeve të ruajtura në bazën e të dhënave kombëtare, në përputhje me nenin 6/6 të urdhrit të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë", sa më shpejt që të jetë e mundur.".

2. Në pikën ADR.AR.A.025 pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c", si më poshtë:

"c) Kur të jetë e zbatueshme sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, Autoriteti i Aviacionit Civil do të vërë në dispozicion të Agjencisë informacionet e rëndësishme që lidhen me sigurinë në operim, të cilat rrjedhin nga raportet e sigurisë së informacionit që ka marrë në përputhje me pikën IS.D.OR.230, të aneksit (Pjesa – IS.D.OR) të rregullores së deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm.".

3. Në pikën ADR.AR.A.030, shkronjat "a", "b" dhe "c" zëvendësohen, si më poshtë:

"a) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë", Autoriteti i Aviacionit Civil do të zbatojë një sistem për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e duhur të informacionit të sigurisë në operim;

b) Agjencia zbaton një sistem për të analizuar në mënyrë të përshtatshme çdo informacion të marrë që lidhet me sigurinë në operim dhe pa vonesa të panevojshme i siguron autoritetit përkatës të shteteve anëtare të ZPEA-së dhe Komisionit çdo informacion, duke përfshirë rekomandimet ose veprimet korrigjuese që duhet të ndërmerren, të nevojshme për ata që të reagojnë në kohën e duhur për një problem të sigurisë në operim që përfshin aerodromet, operatorët e aerodromit dhe organizatat përgjegjëse për ofrimin e AMS-së, të cilët i nënshtrohen VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

c) Me marrjen e informacionit të përmendur në shkronjën "a" dhe kur është e zbatueshme në shkronjën "b", Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masat e duhura për të adresuar problemin e sigurisë në operim, duke përfshirë nxjerrjen e direktivave të sigurisë në operim në përputhje me pikën ADR.AR.A.040.".

4. Pas pikës ADR.AR.A.030 shtohet pika ADR.AR.A.030A, si më poshtë:

ADR.AR.A.030A Reagimi i menjëhershëm ndaj një incidenti ose cenueshmërie të sigurisë

së informacionit me ndikim në sigurinë në operim të aviacionit

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të zbatojë një sistem për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e duhur të informacionit, në lidhje me incidentet dhe cenueshmëritë e sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim që raportohen nga organizatat. Kjo do të bëhet në koordinim me çdo autoritet tjetër përkatës përgjegjës për sigurinë e informacionit ose sigurinë kibernetike brenda Republikës së Shqipërisë për të rritur koordinimin dhe përputhshmërinë e skemave të raportimit;

b) Agjencia zbaton një sistem për të analizuar në mënyrë të përshtatshme çdo informacion të rëndësishëm për sigurinë në operim të marrë në përputhje me pikën ADR.AR.A.025"c" dhe pa vonesë të panevojshme i ofron shteteve anëtare dhe Komisionit çdo informacion, duke përfshirë rekomandimet ose veprimet korrigjuese që duhen ndërmarrë, të nevojshme që ato të reagojnë në kohën e duhur ndaj një incidenti ose cenueshmërie të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit që përfshin produkte, pjesë, pajisje të painstaluara, persona ose organizata që i nënshtrohen VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

c) Pas marrjes së informacionit të përmendur në shkronjën "a" dhe, kur është e zbatueshme, në shkronjën "b", Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të marrë masa të mjaftueshme për të adresuar ndikimin e mundshëm në sigurinë e aviacionit të incidentit ose cenueshmërisë së sigurisë së informacionit;

d) Masat e marra në përputhje me shkronjën "c" duhet t'u njoftohen menjëherë të gjithë personave ose organizatave që duhet t'i zbatojnë ato sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Autoriteti i Aviacionit Civil duhet gjithashtu t'i a njoftojë këto masa Agjencisë dhe kur kërkohet veprim i kombinuar, autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare të përfshira.".

5. Pika ADR.AR.B.005 ndryshohet, si më poshtë:

a) shkronja "a"/1 zëvendësohet me sa vijon:

"1. Politikat dhe procedurat e dokumentuara për të përshkruar organizimin, mjetet dhe metodat e tij për të arritur pajtueshmërinë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Procedurat do të mbahen të përditësuara dhe do të shërbejnë si dokumente themelore të punës brenda Autoritetit të Aviacionit Civil për të gjitha detyrat përkatëse";

b) shkronja "c" zëvendësohet me sa vijon:

"c) Autoriteti i Aviacionit Civil do të vendosë procedurat për pjesëmarrjen në një shkëmbim të ndërsjellë të të gjithë informacionit dhe ndihmës së nevojshme me autoritetet e tjera kompetente të interesuara, qofshin brenda Shqipërisë ose nga shtete të tjera, duke përfshirë:

1. gjetjet përkatëse të ngritura dhe veprimet vijuese të ndërmarra si rezultat i mbikëqyrjes së organizatave përgjegjëse për ofrimin e AMS-së në territorin e Republikës së Shqipërisë, por që kanë deklaruar aktivitetet e tyre me më shumë se një autoritet kompetent ose në më shumë se një shtet;

2. informacionin që rrjedh nga raportimi i detyrueshëm dhe vullnetar i ngjarjeve siç kërkohet nga pikat ADR.OR.C.030 dhe ADR.OR.F.055.

d) Përveç kërkesave të përfshira në shkronjën "a", sistemi i menaxhimit i krijuar dhe i mirëmbajtur nga Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të jetë në përputhje me aneksin I (Pjesa – IS.AR) të rregullores zbatuese të BE 2023/203, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat dhe Autoritet Kompetente, kur të jetë e zbatueshme, me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm, me qëllim që të sigurohet menaxhimi i duhur i rreziqeve të sigurisë së informacionit që mund të kenë ndikim në sigurinë në operim të aviacionit.".

6. Pika ADR.AR.B.010 ndryshohet, si më poshtë:

i. titulli zëvendësohet me sa vijon:

"**ADR.AR.B.010. Ndarja e detyrave**";

ii. shtohet shkronja "c", si më poshtë:

"c) Lidhur me certifikimin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së organizatës me pikën ADR.OR.D.005A, Autoriteti i Aviacionit Civil mund t'u caktojë detyra subjekteve të kualifikuara në përputhje me shkronjën "a" ose çdo autoriteti përkatës përgjegjës për sigurinë e informacionit, ose

sigurinë kibernetike brenda Republikës së Shqipërisë. Gjatë ndarjes së detyrave, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të sigurojë që:

1. të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë në operim koordinohen dhe merren parasysh nga subjekti i kualifikuar ose autoriteti përkatës;

2. rezultatet e aktiviteteve të certifikimit dhe mbikëqyrjes të kryera nga subjekti i kualifikuar ose autoriteti përkatës janë të integruara në dosjet e përgjithshme të certifikimit dhe mbikëqyrjes së organizatës;

3. sistemi i vet i menaxhimit të sigurisë së informacionit, i krijuar në përputhje me pikën ADR.AR.B.005"e" mbulon të gjitha detyrat e certifikimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të kryera në emër të tij.".

7. Pika ADR.AR.B.015 zëvendësohet, si më poshtë:

" ADR.AR.B.015 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit:

a) Autoriteti i Aviacionit Civil do të ketë një sistem për të identifikuar ndryshimet që ndikojnë në aftësinë për të kryer detyrat e tij dhe për të përmbushur përgjegjësitë e veta, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Ky sistem do të mundësojë që ai të marrë masa, sipas nevojës për të siguruar që sistemi i menaxhimit të mbetet i përshtatshëm dhe efektiv;

b) Autoriteti i Aviacionit Civil do të përditësojë sistemin e tij të menaxhimit për të pasqyruar çdo ndryshim të mundshëm në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe në bazë të tij, në kohën e duhur për të siguruar zbatimin efektiv të sistemeve të tij të menaxhimit;

c) Kur të jetë e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil do të njoftojë Agjencinë për ndryshimet që ndikojnë në aftësinë e tij për të kryer detyrat dhe përmbushur përgjegjësitë e veta të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar.".

8. Në pikën ADR.AR.C.005, pas shkronjës "e" shtohet shkronja "f", si më poshtë:

"f) Lidhur me certifikimin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë së organizatës me pikën ADR.OR.D.005A, përveç përputhshmërisë me shkronjat "a" deri në "e", Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të shqyrtojë çdo miratim të dhënë sipas pikës IS.I.OR.200"e" të rregullores zbatuese (BE) 2023/203, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat dhe për autoritetet kompetente, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm ose shkronjës IS.D.OR.200"e" të rregullores së deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat, kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm, pas ciklit të zbatueshëm të auditimit të mbikëqyrjes dhe sa herë që zbatohen ndryshime në fushëveprimin e punës së organizatës.".

9. në pikën ADR.AR.C.035, shkronja "c" zëvendësohet, me sa vijon:

"c) Autoriteti i Aviacionit Civil do të lëshojë certifikatën(at) e përmendura në shkronjën "b" kur operatori i aerodromit të ketë vërtetuar në mënyrë të pranueshme për Autoritetin e Aviacionit Civil përputhjen me kërkesat e pikave ADR.OR.B.025 dhe ADR.OR.E.005. Kur operatori i aerodromit ndryshon, operatorit të ri të aerodromit nuk do t'i kërkohet të demonstrojë përputhjen me kërkesat e përcaktuara në pikën ADR.OR.B.025"a"/1 dhe pikën ADR.OR.E.005, nëse këto kërkesa kanë të bëjnë me elemente që mbeten të pandryshuara.".

10. pas pikës ADR.AR.C.040 shtohet pika ADR.AR.C.040A, si më poshtë:

"ADR.AR.C.040A Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit:

a) Lidhur me ndryshimet e menaxhuara dhe të njoftuara Autoritetit të Aviacionit Civil në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën IS.D.OR.255"a" të aneksit (Pjesa–IS.D.OR) të rregullores së deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të përfshijë shqyrtimin e ndryshimeve të tilla në mbikëqyrjen e tij të vazhdueshme në

përputhje me parimet e përcaktuara në pikën ADR.AR.C.005. Nëse gjendet ndonjë mospërputhje, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të njoftojë organizatën për këtë, të kërkojë ndryshime të mëtejshme dhe të veprojë në përputhje me pikën ADR.AR.C.055;

b) Lidhur me ndryshimet e tjera që kërkojnë një aplikim për miratim në përputhje me pikën IS.D.OR.255"b" të aneksit (Pjesa–IS.D.OR) të rregullores së deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm.

1. Pas marrjes së aplikimit për ndryshim, Autoriteti i Aviacionit Civil duhet të kontrollojë përputhshmërinë e organizatës me kërkesat përkatëse përpara se të lëshojë miratimin;

2. Autoriteti i Aviacionit Civil përcakton kushtet sipas të cilave organizata mund të veprojë gjatë zbatimit të ndryshimit;

3. nëse është i bindur se organizata përputhet me kërkesat përkatëse, Autoriteti i Aviacionit Civil miraton ndryshimin.".

11. Pas pikës ADR.AR.C.055 shtohet pika ADR.AR.C.060 si më poshtë:

"ADR.AR.C.060 Ndërrimi i operatorit të aerodromit

Me marrjen e një aplikimi për ndryshimin e operatorit të aerodromit, në përputhje me pikën ADR.OR.B.060, Autoriteti i Aviacionit Civil:

a) lëshon certifikatën(et) e re në përputhje me pikën ADR.AR.C.035;

b) revokon certifikatën(at) e mëparshme;

5. Në aneksin III bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) pas pikës ADR.OR.B.050 shtohet pika ADR.OR.B.060, si më poshtë:

"ADR.OR.B.060 Ndërrimi i operatorit të aerodromit

a) Operatori aktual i aerodromit do t'i njoftojë Autoritetit të Aviacionit Civil datën në të cilën do të ndodhë transferimi;

b) Operatori i ri të cilit do t'i transferohet menaxhimi i aerodromit do të aplikojë për një certifikatë pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, përpara datës në të cilën do të kryhet transferimi, në përputhje me pikën ADR.OR.B.015;

c) Operatori i ri, të cilit do t'i transferohet menaxhimi i aerodromit, duhet të demonstrojë pajtueshmërinë, në përputhje me pikën ADR.OR.B.025. Operatorit të ri të aerodromit nuk do t'i kërkohet të demonstrojë përputhjen me kërkesat e përcaktuara në pikën ADR.OR.B.025"a"/1 dhe pikën ADR.OR.E.005, nëse këto kërkesa kanë të bëjnë me elemente që mbeten të pandryshuara;";

b) Në pikën ADR.OR.C.020, pas shkronjë "c" shtohet shkronja "d", si më poshtë:

"d) informon organizatat e shërbimeve të përpunimit në tokë në aerodrom për veprimin e ndërmarrë për të adresuar mospërputhjen kur mospërputhja ndikon drejtpërdrejt në rrezikun e sigurisë në operim brenda këtyre organizatave të shërbimit të përpunimit në tokë ose në përgjegjësitë e tyre.";

c) Pika ADR.OR.C.030 zëvendësohet me sa vijon:

"ADR.OR.C.030 Raportimi i ngjarjeve

a) Si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, operatori i aerodromit do të krijojë dhe mirëmbajë një sistem raportimi të ngjarjeve, duke përfshirë raportimin e detyrueshëm dhe vullnetar. Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që sistemi të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të urdhrit të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) Operatori i aerodromit do t'i raportojë Autoritetit të Aviacionit Civil dhe çdo organizate tjetër të kërkuar nga legjislacioni kombëtar çdo ngjarje ose gjendje, të lidhur me sigurinë në operim që rrezikon ose, nëse nuk korrigjohet ose adresohet, mund të rrezikojë një avion, pasagjerët e tij ose çdo person tjetër, dhe në veçanti çdo aksident ose incident serioz;

c) Përveç raporteve të paraqitura në përputhje me shkronjën "b", operatori i aerodromit do t'i raportojë Autoritetit të Aviacionit Civil dhe organizatës përgjegjëse për projektimin e pajisjeve të aerodromit çdo mosfunksionim, defekt teknik, tejkalim të kufizimeve teknike, dukuri ose rrethanë tjetër të parregullt që ka ose mund të ketë rrezikuar

një avion, pasagjerët e tij ose çdo person tjetër dhe nuk ka rezultuar në një aksident ose incident serioz;

d) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë", raportet e përmendura në shkronjën "c" do të:

1. Bëhen sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast brenda 72 orëve nga momenti kur operatori i aerodromit të ketë marrë dijeni për ngjarjen ose gjendjen me të cilën lidhet raporti, përveç rasteve kur rrethanat e jashtëzakonshme e pengojnë këtë;

2. Bëhen në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;

3. Përmbajnë të gjithë informacionin përkatës në lidhje me gjendjen e njohur për operatorin e aerodromit.

e) Pa cenuar urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë", për raportet e kërkuara nga shkronja "c" operatori i aerodromit duhet të paraqesë një raport pasues që ofron detaje të veprimeve që operatori i aerodromit synon të ndërmarrë për të parandaluar ngjarje të ngjashme në të ardhmen. Raporti pasues do të dorëzohet sapo këto veprime të jenë identifikuar dhe ai duhet:

1. t'u dërgohet subjekteve përkatëse të raportuara fillimisht në përputhje me shkronjat "b" dhe "c";

2. të bëhet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.";

ç) Në pikën ADR.OR.D.005, shtohet shkronja "f", si më poshtë:

"f) Nëse operatori i aerodromit është pjesë e një subjekti juridik që mban një ose më shumë certifikata, miratime ose autorizime shtesë organizative, ose deklaron aktivitetet e tij në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, operatori i aerodromit mund ta integrojë sistemin e tij të menaxhimit në sistemin e menaxhimit të kërkuar sipas kësaj rregulloreje.";

d) Në pikën ADR.OR.D.005"b", pika 11 zëvendësohet me sa vijon:

"11. Një funksion për të monitoruar përputhshmërinë e organizatës me kërkesat përkatëse dhe përshtatshmërinë e procedurave; Monitorimi i përputhshmërisë duhet të përfshijë një sistem reagimi të gjetjeve për menaxherin përgjegjës për të siguruar zbatimin efektiv të veprimeve korrigjuese, sipas nevojës.";

dh) Pas pikës ADR.OR.D.005 shtohet pika ADR.OR.D.005A, si më poshtë:

"**ADR.OR.D.005A Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit**

Operatori i aerodromit duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit në përputhje me rregulloren e deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm, me qëllim që të sigurojë menaxhimin e duhur të rreziqeve të sigurisë së informacionit që mund të kenë ndikim në sigurinë në operim.";

e) Pika ADR.OR.D.007 zëvendësohet me sa vijon:

"ADR.OR.D.007 Menaxhimi i të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik

a) Si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, operatori i aerodromit duhet të zbatojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi të cilësisë që mbulon aktivitetet e mëposhtme:

1. aktivitetet e tij të të dhënave aeronautike;

2. aktivitetet e tij të ofrimit të informacionit aeronautik;

b) Si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, operatori i aerodromit duhet të krijojë një sistem menaxhimi sigurie për të garantuar sigurinë e të dhënave operative që ai merr, prodhon ose përdor, në mënyrë që akesi në ato të dhëna operative të kufizohet vetëm për personelin e autorizuar;

c) Sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet të përcaktojë elementet e mëposhtme:

1. Procedurat që lidhen me vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut të sigurisë së të dhënave, monitorimin dhe përmirësimin e sigurisë, rishikimet e sigurisë dhe shpërndarjen e mësimeve të marra;

2. Mjetet e projektuara për të zbuluar shkeljet e sigurisë dhe për të njoftuar personelin me paralajmërime të përshtatshme sigurie;

3. Mjetet për të kontrolluar efektet e shkeljeve të sigurisë dhe për të identifikuar veprimet e rimëkëmbjes dhe procedurat e zbutjes për të parandaluar përsëritjen;

d) Operatori i aerodromit duhet të garantojë autorizimin e sigurisë së personelit të tij, në lidhje me sigurinë e të dhënave aeronautike.

e) Aspektet që lidhen me sigurinë e informacionit duhet të menaxhohen në përputhje me pikën ADR.OR.D.005A.";

ë) Pika ADR.OR.D.020 ndryshohet, si më poshtë:

i. shkronja "b" zëvendësohet me sa vijon:

"b) Operatori i aerodromit cakton zona të përshtatshme në aerodrom që do të përdoren për ruajtjen e mallrave të rrezikshme të transportuara përmes aerodromit. Kushtet e ruajtjes për mallrat e rrezikshme duhet të garantojnë të dyja sa në vijim:

1. Ndarja e mallrave të rrezikshme mund të sigurohet sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të rekomanduara;

2. Facilitetet ofrojnë kushte të përshtatshme për të parandaluar çdo dëmtim të artikujve të mallrave të rrezikshme.";

ii. pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c", si më poshtë:

"c) Kur operatori i aerodromit cakton, gjithashtu, zona të përshtatshme në aerodrom që do të përdoren për ruajtjen e pajisjeve të ngarkim-shkarkimit, ai duhet të sigurojë që këto zona të jenë të përshtatshme për të parandaluar dëmtimin, përkeqësimin ose ruajtjen e tyre në tokë dhe për të siguruar mbrojtje nga kushte të pafavorshme të motit.";

f) Pika ADR.OR.D.025 zëvendësohet me sa vijon:

"ADR.OR.D.025 Koordinimi me organizatat e tjera

Operatori i aerodromit do të:

a) garantojë se sistemi i tij i menaxhimit adreson koordinimin dhe ndërveprimin me procedurat e sigurisë në operim të organizatave të tjera që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom;

b) garantojë se këto organizata kanë në fuqi procedura mbi sigurinë në operim me qëllim përmbushjen e kërkesave të zbatueshme të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe kërkesave të përcaktuara në manualin e aerodromit të krijuar dhe mirëmbajtur në përputhje me pikën ADR.OR.E.005 të këtij aneksi.";

g) Pika ADR.OR.D.027 zëvendësohet me sa vijon:

"ADR.OR.D.027 Programet e sigurisë në operim dhe komitetet e sigurisë në operim të aerodromit

a) Si pjesë e sistemit të tij të menaxhimit, operatori i aerodromit do të krijojë, zbatojë dhe udhëheqë programe sigurie në operim për të promovuar dhe rritur sigurinë në operim, duke përfshirë sigurinë në operim të pistës dhe shkëmbimin e informacionit të rëndësishëm për sigurinë në operim me të gjitha organizatat përkatëse që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom. Operatori i aerodromit duhet të rishikojë, të paktën çdo vit, efektivitetin e programeve të tij të sigurisë në operim;

b) Si pjesë e programeve të sigurisë në operim të përmendura në shkronjën "a", operatori i aerodromit duhet:

1. të krijojë, udhëheqë dhe të jetë përgjegjës për funksionimin e ekipit lokal të sigurisë në operim të pistës dhe komiteteve të tjera të sigurisë në operim të aerodromit;

2. kërkojë nga të gjitha organizatat përkatëse që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom që të marrin pjesë në ekipin lokal të sigurisë në operim të pistës dhe në komitetet e tjera të sigurisë në operim të aerodromit nëpërmjet përfaqësuesve të emëruar që kanë ekspertizën e duhur dhe të përshtatshme operacionale, përkatësisht me subjektin e ekipit lokal të sigurisë në operim të pistës ose përkatësisht komitetit(eve) të sigurisë në operim të aerodromit;

c) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që:

1. Ekipi lokal i sigurisë në operim të pistës dhe komitetet e tjera të sigurisë në operim të aerodromit organizojnë rregullisht mbledhje, frekuenca e të cilave do të përcaktohet bazuar [të paktën] në:

i. dendësinë e trafikut të aerodromit;

ii. kompleksitetin e konfigurimit të aerodromit;

iii. llojin e operimeve;

iv. ngjarjet e sigurisë në operim në aerodrom dhe risqet e mundshme të identifikuara nga analiza e tyre;

2. Propozimet dhe veprimet e ekipit lokal të sigurisë në operim të pistës dhe komiteteve të tjera të sigurisë në operim të aerodromit regjistrohen në një plan veprimi dhe ndiqen për të siguruar zbatimin e tyre në kohën e duhur;

d) Ekipi lokal i sigurisë në operim të pistës dhe komitetet e tjera të sigurisë në operim të aerodromit duhet të:

1. mbështesin identifikimin dhe rishikimin multidisiplinor të çështjeve lokale të sigurisë në

operim, veçanërisht në lidhje me sigurinë në operim të pistës;

2. propozojnë masat e mundshme zbutëse dhe planet përkatëse të veprimit që do të zbatohen nga organizatat përkatëse për të rritur sigurinë në operim;

3. marrin në konsideratë nevojën për të zhvilluar fushata të rregullta lokale të ndërgjegjësimit për sigurinë në operim dhe programe të përbashkëta trajnimi për personelin e të gjitha organizatave përkatëse;

e) Operatori i aerodromit vendos dhe zbaton një procedurë ose procedura për të siguruar zbatimin e shkronjave "a" deri në "d".";

gj) Në pikën ADR.OR.D.030, shtohet "ab", si më poshtë:

"ab) Operatori i aerodromit do të krijojë marrëveshje raportimi me të gjitha organizatat që operojnë ose ofrojnë shërbime në aerodrom, aktivitetet ose produktet e të cilave mund të kenë ndikim në sigurinë në operim të avionit.";

h) Në pikën ADR.OR.E.005, shkronja "f" zëvendësohet me sa vijon:

"f) Pavarësisht shkronjës "e", kur kërkohen ndryshime ose rishikime në interes të sigurisë në operim, ato mund të publikohen dhe të zbatohen menjëherë, me kusht që të jetë aplikuar për marrjen e çdo miratimi të kërkuar. Ndryshimet dhe rishikimet në lidhje me aktivitetet e shërbimit në tokë që i nënshtrohen rregullores së deleguar të Komisionit të BE-së 2025/20, që përcakton kërkesat për ofrimin e sigurt të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe për organizatat që i ofrojnë ato, nuk kërkohet që t'i paraqiten autoritetit kompetent për miratim.";

i) në pikën ADR.OR.F.045, shtohet shkronja "d", si më poshtë:

"d) Pavarësisht shkronjave "a" deri në "c", nëse ofruesi i AMS-së është pjesë e një subjekti juridik që deklaron përgjegjësinë e tij për ofrimin e shërbimeve në tokë, në përputhje me rregulloren e deleguar të BE-së 2025/20, që përcakton kërkesat për ofrimin e sigurt të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe për organizatat që i ofrojnë ato, ofruesi i AMS-së mund ta integrojë sistemin e tij të menaxhimit me sistemin e menaxhimit të kërkuar sipas kësaj rregulloreje.";

j) Pika e mëposhtme ADR.OR.F.045A shtohet pas pikës ADR.OR.F.045:

"ADR.OR.F.045A Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit

Organizata përgjegjëse për ofrimin e AMS-së duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit në përputhje me rregulloren e deleguar të BE-së 2022/1645, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat kur të jetë e zbatueshme me përafrimin e saj me legjislacionin e brendshëm, me qëllim sigurimin e menaxhimit të duhur të rreziqeve të sigurisë së informacionit që mund të kenë ndikim në sigurinë në operim të aviacionit.";

k) Në pikën ADR.OR.F.055 shtohet shkronja "e". si më poshtë:

"e) Organizata përgjegjëse për ofrimin e AMS-së duhet të sigurojë që çdo ngjarje t'i raportohet personit që kryen një funksion të lidhur me menaxhimin e sigurisë në operim të operatorit të aerodromit, në përputhje me nenin 4/6, shkronja "e", të urdhrit të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë".".

6. Në aneksin IV bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) shtohet pika e mëposhtme ADR.OPS.B.011:

"ADR.OPS.B.011 Heqja e avionëve jashtë funksionit

a) Operatori i aerodromit do të krijojë një plan për heqjen e një avioni jashtë funksionit në zonën e lëvizjes dhe do të caktojë një koordinator aerodromi për të zbatuar planin;

b) Plani i heqjes së avionit jashtë funksionit duhet të përfshijë sa vijon:

1. detajet e kontaktit të koordinatorit të aerodromit për operimet mbi heqjen e një avioni jashtë funksioni në ose ngjitur me zonën e lëvizjes;

2) përgjegjësitë, veprimet dhe linjat e komunikimit për secilën organizatë të përfshirë;

3) një listë të pajisjeve dhe një listë të personelit në, ose në afërsi të aerodromit, të cilat janë të disponueshme për këtë qëllim;

4) çdo marrëveshje për marrjen e shpejtë të kompleteve të pajisjeve të rikuperimit të avionëve të disponueshëm nga aerodrome të tjerë, sipas rastit.";

b) Në pikën ADR.OPS.B.031 shtohen shkronjat "c" dhe "d", si më poshtë:

"c) Nëse sinjalet përdoren në përputhje me shkronjën "b"/4, ato do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

Sinjali i dritës nga kontrolli i aerodromit	Kuptimi
Pulsime/Fleshime jeshile	Leje për të kaluar zonën e uljes ose për të lëvizur në rrugë lidhëse
E kuqe e qëndrueshme	Ndaloni
Pulsime/Fleshime të kuqe	Lëvizni nga zona e uljes ose rruga lidhëse dhe kini kujdes avionët
Pulsime/Fleshime të bardha	Dilni nga zona e manovrimit, në përputhje me udhëzimet lokale

d) Në kushte emergjence ose nëse sinjalet në shkronjën "c" nuk shikohen, sinjali i dhënë më poshtë do të përdoret për pistat ose rrugët lidhëse të pajisura me një sistem ndriçimi dhe do të ketë kuptimin e mëposhtëm:

Sinjali i dritës nga kontrolli i aerodromit	Kuptimi
Dritat pulsuese të pistës ose rrugës lidhëse	Dilni nga pista dhe vëzhgoni kullën për sinjal drite

c) Pika ADR.OPS.B.033:

i) shkronja "a"/3) zëvendësohet me sa vijon:

"3) kontrolluar lëvizjen e personave në vendqëndrimin e avionëve";

ii. shtohet shkronja e mëposhtme "a1":

"a1)Operatori i aerodromit duhet të vendosë procedura për të siguruar që pasagjerët që hipin ose zbresin nga një avion, ose që kanë nevojë të ecin në, nga ose përtej vendqëndrimit të avionëve:

1. të shoqërohen nga personel i trajnuar dhe kompetent;

2. nuk ndërhyjnë në aktivitetet e shërbimit të avionëve të palëvizshëm dhe aktivitetet e shërbimeve të përpunimit në tokë;

3. janë të mbrojtur nga avionët që janë në operim, duke përfshirë efektet e motorëve të tyre, si dhe aktivitete të automjeteve ose aktivitete të tjera.";

ç) Pika ADR.OPS.B.070 zëvendësohet me sa vijon:

adr.OPS.B.070 Siguria në operim e punimeve në aerodrom

a) Operatori i aerodromit do të vendosë dhe zbatojë një proces për menaxhimin e sigurisë në operim të aerodromit gjatë punimeve në zonën e lëvizjes.

b) Procesi do të përcaktojë dhe dokumentojë përgjegjësitë, në lidhje me:

1. autorizimin për kryerjen e punimeve;

2. zbatimin e çdo ndryshimi të propozuar në hapësirat ku operohet;

3. datën dhe orën kur operimet në hapësirat do të kufizohen ose ndërpriten;

4. metodat me të cilat do të shpallen ndryshime të tilla;

5. mbikëqyrjen dhe kontrollin e punimeve në vazhdim;

6. pajtueshmërinë me të gjitha rregullat përkatëse të sigurisë në operim të zonës së lëvizjes;

c) Procesi për menaxhimin e sigurisë në operim të aerodromit gjatë punimeve duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

1. një procedurë të planifikimit të punimeve;

2. një procedurë për vlerësimin e impaktit të sigurisë në operim të ndryshimeve të planifikuara në operimet ose sistemet e aerodromit;

3. procedurën e autorizimit të punimeve;

4. një procedurë për shpalljen e informacionit në lidhje me punimet;

5. një procedurë për vendosjen e kantierit dhe kthimin në operim;

6. një procedurë për monitorimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e punimeve;

d) Aty ku kërkohen operime me gjatësi të reduktuar të pistës për shkak të punimeve, operatori i aerodromit duhet të zhvillojë dhe zbatojë një procedurë për operime të tilla.";

d) Pas pikës ADR.OPS.B.070 shtohet pika ADR.OPS.B.071 si më poshtë:

"ADR.OPS.B.071 Pistat dhe rrugët lidhëse të mbyllura, ose pjesë të tyre

a) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që vijëzimet e mbylljes të shfaqen mbi:

1. një pistë ose një rrugë lidhëse, ose një pjesë e saj, e cila është e mbyllur përgjithmonë për t'u përdorur nga të gjithë avionët;

2. një pistë ose rrugë lidhëse e mbyllur përkohësisht, ose një pjesë e saj, përveç rasteve kur këto vijëzime mund të anashkalohen kur mbyllja është me kohëzgjatje të shkurtër dhe kur ofrohet paralajmërimi i duhur nga shërbimet e trafikut ajror;

b) Me përjashtim të shkronjës "a", një vijëzim mbylljeje nuk duhet të shfaqet në një rrugë lidhëse të mbyllur përgjithmonë ose pjesë të saj, nëse hyrja në rrugën lidhëse të mbyllur, ose pjesë të saj është e shënuar dhe e ndriçuar me drita dhe shënues të mospërdorimit;

c) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që kur një pistë ose një rrugë lidhëse, ose një pjesë e saj

mbyllet përgjithmonë të gjitha vijëzimet e pistës dhe rrugës lidhëse hiqen fizikisht;

d) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që ndriçimi në një pistë ose rrugë lidhëse të mbyllur, ose në një pjesë të saj, të mos jetë i ndezur, përveçse kur kërkohet për qëllime mirëmbajtjeje;

e) Operatori i aerodromit duhet të sigurojë që përveç vijëzimeve mbyllëse, kur një pistë, një rrugë lidhëse ose një pjesë e saj mbyllet dhe ndërpritet nga një pistë ose rrugë lidhëse, e cila përdoret gjatë natës, të vendosen dritat e papërdorshmërisë përgjatë hyrjes në zonën e mbyllur.";

dh) Pika ADR.OPS.B.090 zëvendësohet me sa vijon:

"ADR.OPS.B.090 Përdorimi i aerodromit nga avionët që tejkalojnë karakteristikat e certifikuara të projektimit të aerodromit

a) Për të lejuar përdorimin e aerodromit ose pjesëve të tij nga avionët që tejkalojnë kodin e germës ose hapjen e jashtme të rrotave të ingranazheve kryesore, ose të dyja karakteristikat e certifikuara të projektimit të aerodromit, operatori i aerodromit duhet të aplikojë për miratimin paraprak tek Autoriteti i Aviacionit Civil, një miratim i tillë nuk kërkohet për situatat emergjente të avionit;

b) Në kërkesën për miratimin paraprak të Autoritetit të Aviacionit Civil për avionët e përmendur në shkronjën "a", operatori i aerodromit do të përfshijë një vlerësim të ndikimit të karakteristikave të mëposhtme të avionit në infrastrukturën e aerodromit, objektet, pajisjet dhe funksionimin e tij dhe anasjelltas:

1. gjerësia e krahëve të avionit;
2. gjerësia ndërmjet skajeve të jashtme të rrotave kryesore të uljes;
3. bazamenti i rrotave;
4. gjatësia e avionit;
5. gjerësia e strukturës së avionit;
6. lartësia e strukturës së avionit;
7. gjeometria e hundës së avionit;
8. lartësia e bishtit;
9. lartësia e majës së krahut nga toka;
10. pamja e kabinës së pilotit;
11. distanca nga pozicioni i syrit të pilotit deri tek pajisja e uljes së parme;
12. konfigurimi i pajisjes kryesore të uljes;
13. sistemi i drejtimit të rrotave;
14. pesha maksimale e avionit;
15. gjeometria e pajisjeve të uljes, presioni i gomave dhe vlerat e klasifikimit të avionit;
16. karakteristikat e motorit të avionit;
17. kapaciteti maksimal i mbajtjes pasagjerëve dhe karburantit;
18. performanca e fluturimit.";

e) Pas pikës ADR.OPS.B.090 shtohen pikat ADR.OPS.B.095 dhe ADR.OPS.B.100 si më poshtë:

"ADR.OPS.B.095 Pikat e nxehta

a) Kurdoherë që është e nevojshme, operatori i aerodromit do të caktojë një vendndodhje ose disa vendndodhje në zonën e lëvizjes së aerodromit si "pikat e nxehta", si pjesë e programit të sigurisë në operim që ka ngritur në përputhje me pikën ADR.OR.D.027;

b) Pasi të jetë identifikuar një pikë e nxehtë, operatori i aerodromit duhet të zbatojë masat për të hequr rrezikun dhe nëse kjo nuk është e mundur menjëherë, t'i japë të dhënat përkatëse aeronautike njësisë përgjegjëse të shërbimeve të informacionit aeronautik (AIS) për publikim në publikimin e informacionit aeronautik (AIP).

ADR.OPS.B.100 Pezullimi i operimeve në pistë dhe mbyllja e pistës

a) Operatori i aerodromit vendos dhe zbaton, në bashkëpunim me shërbimet e trafikut ajror, procedurat për pezullimin e përkohshëm të operimeve në pistë ose mbylljen e planifikuar të pistës.

b) Procedurat duhet të përmbajnë sa vijon:

1. rolet dhe përgjegjësitë e operatorit të aerodromit, shërbimeve të trafikut ajror dhe organizatave të tjera të përfshira në operimet e aerodromit, sipas situatës;
2. aksesin e personelit në pistën e mbyllur;
3. masat e sigurisë në operim, në përputhje me pikat ADR.OPS.B.070 dhe ADR.OPS.B.071;
4. publikimin e një NOTAM-i, në përputhje me pikën ADR.OPS.A.057, me përjashtim të rasteve kur pezullimi i operimeve në pistë pritet të jetë me kohëzgjatje të shkurtër;
5. veprimet përpara rifillimit të operimeve në pistës.";

ë) Pas pikës ADR.OPS.C.010 shtohet pika ADR.OPS.C.011, si më poshtë:

"ADR.OPS.C.011 Operimet me ngarkesë të tepërt

Kurdoherë që aerodromi pritet të përdoret rregullisht nga avionë që mund të dëmtojnë dyshemetë, operatori i aerodromit vendos kritere për operimet me ngarkesë të tepërt.".

f) Në pikën ADR.OPS.D.001, shkronja "a"/4 zëvendësohet me sa vijon:

"4) të mbulojnë sa vijon:

i. caktimin e vendqëndrimeve të avionëve;

ii. ofrimin e shërbimeve të drejtimit të avionëve;

iii. parkimin dhe nisjen e avionëve nga vendqëndrimi;

iv. masat paraprake të mbrojtjes nga efekti i goditjes gjatë vënies në punë të motorëve dhe testimit të motorëve;

v. udhëzimet/autorizimet e nisjes dhe udhëzimet për lëvizjen në rrugët lidhëse.";

g) Pika ADR.OPS.D.060 zëvendësohet me sa vijon:

"ADR.OPS.D.060 Siguria në vendqëndrim gjatë furnizimit me karburant të avionit

a) Operatori i aerodromit duhet të hartojë një procedurë për të garantuar sigurinë e operimeve në vendqëndrim gjatë furnizimit me karburant të avionit;

b) Procedura duhet të kërkojë sa vijon:

1. ndalimin e flakëve të hapura dhe përdorimin e mjeteve elektrike ose të ngjashme nga personeli në afërsi të pikës së furnizimit me karburant, të cilat mund të prodhojnë shkëndija ose harqe elektrike brenda zonës së furnizimit me karburant;

2. ndalimin e ndezjes së njësive të karikimit me energji tokësore gjatë furnizimit me karburant;

3. për autobotet për transportin e karburantit: ekzistencën e një rruge të papenguar nga avioni për të lejuar largimin e shpejtë të autoboteve për transportin e karburantit dhe personave në rast emergjence;

4. lidhjen e saktë të burimeve të furnizimit të avionëve dhe karburantit si dhe zbatimin e saktë të procedurave të tokëzimit;

5. njoftimin e menjëhershëm të ofruesit të shërbimit të furnizimit me karburant në avion në rast të derdhjes së karburantit dhe udhëzimet e hollësishme se si të trajtohen derdhjet e karburantit;

6. pozicionimin e pajisjeve mbështetëse të përpunimit në tokë në mënyrë të tillë që daljet e emergjencave të jenë të lira nga çdo pengesë për të lejuar evakuimin e shpejtë të pasagjerëve, nëse pasagjerët hipin ose zbresin ose qëndrojnë në avion gjatë furnizimit me karburant;

7. disponueshmërinë e menjëhershme të fikësve të zjarrit të llojit të përshtatshëm për të paktën ndërhyrjen fillestare në rast zjarri nga karburanti;

8. sigurimin e daljes pa pengesa për automjetin që furnizon me karburant dhe aksesin pa pengesa në hidrantin e karburantit dhe në ndalesën e emergjencës;

9. ndërprerjen e operimeve të furnizimit me karburant nëse ka stuhi elektrike në aerodrom ose në afërsi të tij.".

II. DISPOZITAT KALIMTARE

1. Pikat 5/"ç", 5/"d", 5/"f", 4/2, 4/4, 4/5, 4/6, 4/8, 4/10, të tekstit do të zbatohen nga data 22 shkurt 2026.

2. Pikat 5/"b", 5/"ë", 5/"h", 5/"i", 6/"c", 6/"f", 6/"g" të tekstit do të zbatohen nga data 27 mars 2028.

URDHËR
Nr. 1386, datë 18.12.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 266, DATË 29.8.2011, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'PËR INDUSTRIALIZIMIN DHE TREGTIMIN E UJËRAVE MINERALE NATYRORE'"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar,

URDHËROJ**:**

1. Fjalia hyrëse e pikës 7 të rregullores "Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale", bashkëlidhur urdhrit nr. 266, datë 28.8.2011, riformulohet si më poshtë:

"7. Burimet e ujërave minerale natyrale mund të shfrytëzohen dhe ujërat e tyre ambalazhohen vetëm nëse janë të pajisur me leje administrative të lëshuar nga organet kompetente për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore dhe plotësohen kushtet e mëposhtme:".

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

VENDIM
Nr. 76, datë 2.12.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari	kryesuese;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 2.12.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (Sh) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Shoqëritë "Malsia Solar 1" sh.p.k., "Malsia Solar 2" sh.p.k., "Malsia Solar 3" sh.p.k., të përfaqësuar nga avokatë Korab Cani dhe Dritan Kruja, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, me autorizim;

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në mungesë;

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3981 (362), datë 23.9.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim prapësimet me shkrim të kërkueseve, shoqërive "Malsia Solar 1" sh.p.k., "Malsia Solar 2" sh.p.k., "Malsia Solar 3" sh.p.k. (*kërkueset*), që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkueset janë subjekte tregtare të regjistruara në datën 19.12.2012, me status aktiv, me seli në Tiranë dhe me të njëjtin objekt veprimtarie, në fushën e energjetikës, si dhe me të njëjtën pronësi të përbashkët shqiptare (E. S. me 18% të kapitalit) dhe të huaj (D. B. me 30%, E. K. A. me 30% dhe PV Consult Albania me 22%, ku kjo e fundit është me pronësi të përbashkët: K. K. 20% dhe G. I. K. me 80% të kapitalit).

2. Në kuadër të ushtrimit të aktivitetit tregtar, në datën 21.6.2014, shoqëritë janë pajisur me autorizim paraprak nga MIE për ndërtimin e një centrali elektrik fotovoltaik në zonën e Malësisë së Madhe. Pasi kanë paraqitur dokumentacionin e nevojshëm ligjor, përmes tre vendimeve të Këshillit të Ministrave të datës 14.1.2015 (*VKM-të nr. 20/2015, nr. 21/2015 dhe nr. 22/2015*), kërkueset kanë marrë autorizimin për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik. Këto vendime kanë përcaktuar se institucioni kompetent për ndjekjen e zbatimit të projektit është MIE dhe afati për përfundimin e ndërtimit të centralit elektrik fotovoltaik është brenda muajit mars 2017 (*pika 1*). Po ashtu, kanë parashikuar edhe rastet kur autorizimet mund të revokohen nga ministria përgjegjëse për energjinë (*pika 7*).

3. Në datën 28.7.2016, Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar tre vendime për dhënien e lejeve të ndërtimit për objektin "Centrali elektrik fotovoltaik 'Malsia Solar 1, 2, 3 sh.p.k.'". Sipas vendimeve, dokumenti i lejes së ndërtimit i jepet subjektit zhvillues (shoqërive kërkuese) vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të njësisë së qeverisjes vendore, në rastin konkret Bashkisë së Malësisë së Madhe.

4. Në vijim, në datën 9.11.2016, shoqëritë kërkuese i janë drejtuar Bashkisë së Malësisë së Madhe dhe për dijeni Kryeministrit, MIE-s dhe

Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (*AZHT*), me kërkesën se bazuar në nenin 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" (*Ligji për Taksat Vendore*) taksa e ndikimit për projektet e ndërtimit të infrastrukturës në energji ishte 0.1% e vlerës së investimit.

5. Në datën 11.11.2016, Bashkia e Malësisë së Madhe i ka kthyer përgjigje kërkueseve se taksa e ndikimit në infrastrukturë që duhet të paguhej prej tyre ishte në masën 3% të vlerës së investimit (9.750.000 euro) dhe përllogaritej në shumën 39.926.250 lekë. Pas kësaj, në datën 14.11.2016, kërkueset i janë drejtuar kryetarit të Bashkisë së Malësisë së Madhe për t'u konsultuar me MIE-n dhe Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për sa i përket nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar Ligjit për Taksat Vendore.

6. Po ashtu, kërkueset, në datën 23.11.2016, kanë paraqitur padi kundër Bashkisë së Malësisë së Madhe, me objekt saktësimin e të drejtave dhe detyrimeve për sa i përkiste taksës së ndikimit në infrastrukturë nga procesi i instalimeve të paneleve diellore në parqet energjetike. Me vendimin nr. 258(296), datë 20.4.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkueseve, me arsyetimin se taksa e ndikimit në infrastrukturë është përcaktuar nga organi i ngarkuar nga ligji, në rastin konkret Bashkia e Malësisë së Madhe dhe gjykata nuk mund të ndërhynte për sa kohë kërkueset nuk kishin kontestuar aktin administrativ, faturën e arkëtimit të lëshuar nga organi publik. Kërkueset e kanë kundërshtuar këtë vendim dhe Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1205, datë 27.3.2018, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak të tërheqjes prej tyre nga ankimimi.

7. Ndërkohë, kërkueset kanë vijuar përpjekjet për përcaktimin në një masë më të vogël të taksës së ndikimit në infrastrukturë edhe në rrugë jogjyqësore. Kështu, me shkresën e datës 12.1.2017, MIE i është drejtuar Kryeministrisë, në të cilën sugjeron se një nga institucionet kompetente për të sqaruar nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë është Ministria e Financave, duke qenë se kjo e fundit ka iniciuar dhe hartuar Ligjin për Taksat Vendore. Me shkresën e datës 23.1.2017, Kryeministria ka njoftuar kërkueset se problematika e ngritur i është dërguar për ndjekje MIE-s.

8. Kërkueset, në datën 30.1.2017, i janë drejtuar Ministrisë së Financave për qartësimin juridik të Ligjit për Taksat Vendore, e cila në datën 6.2.2017, ka sqaruar përfundimisht se taksa e ndikimit në infrastrukturë duhet të jetë 0.1% e vlerës së investimit. Gjithashtu, MIE, me shkresën e datës 20.2.2017, ka informuar kërkueset se objekti në rastin konkret është një projekt për ndërtimin e infrastrukturës në energji dhe, për rrjedhojë, referuar ligjit të vitit 2015, që ka ndryshuar Ligjin për Taksat Vendore, taksa e ndikimit në infrastrukturë duhet të jetë 0.1% e vlerës së investimit.

9. Në vijim, në datën 30.8.2017, kërkueset i janë drejtuar përsëri Bashkisë së Malësisë së Madhe për faturimin e taksës në infrastrukturë në masën 0.1% të vlerës së investimit. Bashkia në fjalë, përmes shkresës së datës 4.9.2017, ka insistuar përsëri që taksa e ndikimit në infrastrukturë do të ishte 3% e vlerës së investimit. Pas kësaj, kërkueset, me shkresën e datës 2.10.2017, i janë drejtuar Kryeministrisë dhe Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes *(MSHMS*), me qëllim zgjidhjen e kësaj situate. Në vijim, MSHMS-ja, në muajin nëntor 2017, ka organizuar një takim ndërmjet kërkueseve dhe Bashkisë së Malësisë së Madhe, ku u arrit në përfundimin se niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë duhet të ishte në masën 0.1% të vlerës së investimit.

10. Pas dërgimit të këtij njoftimi dhe përgatitjes në datën 13.12.2017, nga Bashkia e Malësisë së Madhe të faturave përkatëse të arkëtimit, kërkueset, në datën 13.1.2018, kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 520.260 lekë secila (gjithsej 1.560.780 lekë për të tria së bashku) dhe në datën 24.1.2018, i janë drejtuar për zbardhjen e lejes së ndërtimit AZHT-së. Kjo e fundit ka njoftuar kërkueset për pamundësinë e zbardhjes së lejeve të ndërtimit, pasi afati i parashikuar në autorizimet për këtë qëllim kishte mbaruar (afati ishte data 31.3.2017).

11. Në këtë situatë, kërkueset, në datën 3.2.2018, i janë drejtuar sekretarit të përgjithshëm të autoritetit kontraktor, MIE-s, me shpjegime për vonesën e fillimit të punimeve. Pas këtij momenti shoqëritë kanë bërë disa kërkesa, duke kërkuar që ministria të njihte vonesat e krijuara nga Bashkia e Malësisë së Madhe dhe të shtynte afatin e ndërtimit të centralit.

12. Me shkresën e datës 10.9.2018, AZHT-ja i është drejtuar MIE-s për të konfirmuar afatet kohore të cilave duhet t'i referohej. Kjo e fundit, me

shkresën e datës 9.10.2018, ka bërë me dije se ka filluar procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të tre projektvendimeve për Këshillin e Ministrave për shtyrjen e afatit të ndërtimit. Ky njoftim u është bërë me dije edhe kërkueseve në datën 15.10.2018 nga AZHT-ja dhe në datën 2.11.2018 nga MIE.

13. Në vijim, sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, me shkresën e datës 9.1.2019, ka kthyer tre projektvendimet te MIE, pasi ka konstatuar se nuk ishin respektuar afatet e përfundimit të punimeve dhe se kërkesa për shtyrje afati ishte paraqitur në tejkalim të përcaktimeve në VKM-të nr. 20/2015, nr. 21/2015 dhe nr. 22/2015. Ky njoftim u është përcjellë kërkueseve me shkresën e datës 28.8.2019 nga MIE.

14. Kërkueset, gjendur në këto rrethana, në datën 11.10.2019, i janë drejtuar gjykatës me padi, me objekt: i. shfuqizimin e veprimit administrativ/shkresës së datës 9.1.2019, të sekretarit të përgjithshëm të Kryeministrisë, njoftuar me shkresën e datës 28.8.2019, të MIE-s; ii. detyrimin e MIE-s që të nënshkruajë shtesën e autorizimit për shtyrjen e afatit të ndërtimit të centralit për një afat 6 mujor nga momenti i miratimit të shtesës së autorizimit; iii. detyrimin e MIE-s të hartojë dhe propozojë projektvendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e shtesës së autorizimit që përmban shtyrjen e afatit të ndërtimit të centralit 6 muaj nga momenti i miratimit të shtesës së autorizimit; iv. detyrimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e projektvendimit të propozuar nga MIE, lidhur me shtesën e autorizimit dhënë kërkueseve; v. detyrimin e palëve të paditura të paguajnë shpenzimet gjyqësore.

15. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 122, datë 9.1.2020, ka vendosur: i. pranimin e pjesshëm të padisë; ii. konstatimin të paligjshëm të veprimit administrativ të formalizuar me shkresën e datës 9.1.2019, të sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për kthimin e projektvendimit; iii. detyrimin e Këshillit të Ministrave që të miratojë tre projektvendimet e iniciuara nga MIE për shtesën e autorizimit; iv. rrëzimin e padisë për palën e paditur, MIE-n, dhe të kërkimeve të tjera.

16. Pas ankimit të paraqitur nga MIE dhe Avokatura e Shtetit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 511, datë 7.10.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, me arsyetimin se vonesa dhe mosrespektimi i afatit të përfundimit të punimeve nuk kanë ardhur si pasojë e pamundësisë së kërkueseve për të përmbushur afatin e përcaktuar në 3 vendimet për miratimin e autorizimeve, por për arsye tërësisht objektive të pavarura nga kërkueset, të shkaktuara nga Bashkia e Malësisë së Madhe për shkak të mospërcaktimit në mënyrë të saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë, që ka sjellë pengimin e kërkueseve për pajisjen me dokumentin e lejes së ndërtimit dhe vijimin e punimeve për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs MIE, e përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit dhe kundërrekurs kërkueset.

17. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin nr. 26, datë 28.4.2022, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe, më pas, me vendimin nr. 00-2024-3981 (362), datë 23.9.2024, ka prishur dy vendimet e gjykatave të faktit dhe ka rrëzuar padinë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

18. Në datën 17.2.2025, kërkueset i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës me aktet e kërkuara, është regjistruar në datën 3.3.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 13.5.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit, në datën 27.5.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në datën 2.12.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtari të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, për shkak se kishte marrë pjesë në dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

19. *Kërkueset*, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se Gjykata e Lartë u ka cenuar:

19.1 Të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

19.1.1 Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj të lidhur me parimin e kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim diametralisht të kundërt nga ato të gjykatave të faktit, ndonëse gjendej përpara faktit se kërkueset janë penguar për të realizuar projektin për të cilin

kanë marrë autorizimet nga Këshilli i Ministrave. Në rastin e tyre pengesë për të vijuar me procedurat e pajisjes me dokumentin e lejes së ndërtimit është bërë dukshëm Bashkia e Malësisë së Madhe, pra vonesa ka ardhur për arsye tërësisht objektive, të pavarura prej tyre. Disponimi nga ajo gjykatë ka sjellë për pasojë edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike*.

19.1.2 Së drejtës për mbrojtje efektive gjyqësore, pasi Gjykata e Lartë nuk ka trajtuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë faktet dhe provat e paraqitura prej tyre, ka anashkaluar në mënyrë të pashpjeguar konkluzionet e gjykatës së apelit dhe të shkallës së parë, të cilat kanë analizuar imtësisht dhe me korrektësi situatën faktike dhe juridike.

19.1.3 Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimit të Gjykatës së Lartë i mungon analiza e fakteve dhe provave, duke mos dhënë asnjë argument ligjor se për përse administrata publike, si ajo në nivel lokal, ashtu edhe në nivel qendror, nuk mori asnjë masë për eliminimin e situatës së paligjshmërisë, lehtësimin e kuptueshmërisë së bazës ligjore dhe nisjen e punimeve. Ndonëse këto shkaqe gjenden të listuara në pjesën përshkruese, në pjesën arsyetuese ato nuk merren në analizë nga Gjykata e Lartë. Mungesa e arsyetimit të vendimit bazuar në ligj dhe në prova ka cenuar pritshmëritë e kërkueseve, në kushtet kur ato kishin fituar të drejta në bazë të akteve administrative.

19.2 Parimin e barazisë përpara ligjit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi kërkueset janë trajtuar në mënyrë arbitrare në raport me praktika të tjera të miratimit të shtesave të autorizimit, duke aplikuar një standard të dyfishtë, ndryshe për investitorët e tjerë në energji dhe ndryshe për to.

19.3 Të drejtën e pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi organet e administratës publike dhe ato vendore kanë mbajtur një qëndrim mohues në kushtet kur investimi nuk mund të vihej në jetë si rezultat i paqartësisë së ligjit dhe veprimeve e mosveprimeve të tyre. Vlera e investimit dhe dëmi ekonomik janë të pallogaritshëm dhe katastrofikë.

19.4 Parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave ka marrë një prerogativë që ligji nuk e përcakton si kompetencë të detyrës funksionale, duke tejkaluar kompetencat e tij. Shkresa për kthimin e 3 projektvendimeve MIE-s është e paligjshme në kuptim të nenit 109 të Kodit të Procedurave Administrative (*KPA*), në kushtet kur sekretari i përgjithshëm ka marrë kompetencat e ekzekutivit. Kërkueset ndodheshin në kushtet e pamundësisë për të kërkuar zgjatjen e afatit të autorizimit përpara mbarimit të afatit, për sa kohë nuk kishin zgjidhur ende mosmarrëveshjen me Bashkinë e Malësisë së Madhe, pasi kjo kohë do të ndikonte në afatin e ndërtimit, për rrjedhojë, në rast mospërfundimi të punimeve brenda afatit, do të humbitnin përfundimisht autorizimet e dhëna me vendimet e Këshillit të Ministrave. Këto veprime u kanë shkaktuar kërkueseve një dëm të pallogaritshëm ekonomik.

19.5 Parimin e proporcionalitetit dhe racionalitetit, të garantuara nga nenet 17 dhe 116 të Kushtetutës, pasi vendimi ka efekt shkatërrues për një investim privat që ndjek objektiva me interes publik (prodhimin e energjisë së pastër). Rrëzimi i padisë pa analizuar pasojat shoqërore, mjedisore dhe financiare, është jo vetëm joproporcional, por edhe joracional.

19.. Parimin e ndarjes së pushteteve, të garantuar nga nenet 7 dhe 135 të Kushtetutës, pasi është mbivlerësuar roli i Kryeministrisë dhe është përjashtuar ministria kompetente nga çdo përgjegjësi. Vendimi ka shtuar konfuzionin institucional dhe ka deformuar mekanizmin e kontrollit ekzekutiv, duke legjitimuar ndërhyrjen arbitrare të një akti administrativ mbi një procedurë që kërkonte akt formal juridik.

20. *Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit*, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim, duke prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, se:

20.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

20.1.1 Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme e caktuar me ligj, kontradiktoritetit dhe sigurisë juridike, nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi kërkueset nuk kanë dhënë argumente në nivel kushtetues. Ndonëse ato pretendojnë shkelje ligjore nga ana e bashkisë, në asnjë rast nuk kanë parashtruar se në ç'mënyrë Gjykata e Lartë u ka cenuar të drejtat dhe parimet e pretenduara. Për më tepër, kërkueset nuk kanë një të drejtë të fituar në cilësinë e "pronës" për t'u mbrojtur në kuptimin kushtetues.

20.1.2 Standardit të arsyetimi të vendimit, është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë në mënyrë të qartë ka argumentuar se në referim të shkaqeve të rekursit, vendimet e gjykatave të faktit janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material mbi rrethanat konkrete të çështjes në gjykim. Për më tepër,

pretendimet e kërkueseve kanë të bëjnë me mënyrën e shqyrtimit dhe vlerësimit të provave dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme. Gjykatat e faktit nuk kanë marrë në konsideratë kompetencat e organeve publike administrative. Përkundër kompetencave të tyre, gjykatat e faktit kanë disponuar detyrimin e Këshillit të Ministrave të miratojë projektvendimin, çka është në kundërshtim me ligjin, pasi ato nuk mund t'i përcaktojnë vullnetin vendimmarrës një organi administrativ para se ai ta shqyrtojë sipas bindjes së brendshme dhe diskrecionit të vlerësimit që i jep ligji.

20.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* nuk qëndron, pasi kërkueset nuk kanë parashtruar asnjë argument në nivel kushtetues. Ato nuk kanë dhënë argumente se kur Gjykata e Lartë ka vepruar në mënyrë të ndryshme në raste të ngjashme.

20.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* qartazi nuk qëndron, pasi në mungesë të një akti përfundimtar administrativ që njeh të drejtën reale ose ekonomike të kërkueseve, siç mund të ishte certifikata e përdorimit që jepet në përfundim të punimeve, nuk mund të flitet për një pronë të njohur ose të fituar sipas ligjit, e cila të gëzojë mbrojtje kushtetuese.

20.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë* është i pabazuar, pasi sekretari i përgjithshëm ka vepruar në ushtrim të kompetencës së tij të plotë për të kthyer aktet te ministrat propozues, në kushtet kur ato ishin në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, kompetencë e cila parashikohet në shkronjën "c", të nenit 9, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" (*Ligji për Këshillin e Ministrave*). Për më tepër, argumentet e kërkueseve, në thelb, kanë të bëjnë me arsyetimin e vendimit të kundërshtuar.

21. *Subjekti i interesuar, MIE*, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueseve

22. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

23. Kërkueset, si persona juridikë, janë subjekte të së drejtës private dhe bartëse të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta, në përputhje me parashikimet e nenit 16 të saj. Ato legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, sepse kanë qenë palë në procesin gjyqësor, në vijim të të cilit është dhënë vendimi gjyqësor objekt kundërshtimi, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

24. Lidhur me kriterin për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, rezulton se kërkueset kanë kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka ndryshuar vendimet e dy gjykatave të faktit dhe ka rrëzuar padinë e tyre, ndaj në këto rrethana ato nuk kanë mjete të tjera ankimi në dispozicion. Për rrjedhojë, e kanë përmbushur edhe këtë kriter, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të Ligjit Organik të Gjykatës.

25. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret Gjykata vëren se vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë mban datën 23.9.2024, ndërsa është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 17.10.2024. Ankimi kushtetues individual është dërguar fillimisht në datën 17.2.2025 dhe në përmbajtje të tij kërkueset kanë parashtruar se vendimi i Gjykatës së Lartë u ka cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor* në drejtim të së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme e caktuar me ligj, kontradiktoritetit, sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit, *parimin e barazisë përpara ligjit, parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë*, si dhe *të drejtën e pronës*. Për këto

pretendime kërkueset legjitimohen *ratione temporis*, pasi i kanë paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

26. Gjithashtu, Gjykata konstaton se në parashtrimet e paraqitura në datën 25.6.2025, kërkueset kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar u ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor edhe në drejtim të *së drejtës për mbrojtje efektive gjyqësore,* për shkak se Gjykata e Lartë ka anashkaluar në mënyrë të pashpjegueshme konkluzionet dhe analizën e detajuar e korrekte të gjykatave të faktit; *parimin e proporcionalitetit dhe racionalitetit*, pasi vendimi nuk ka analizuar pasojat shoqërore, mjedisore dhe financiare; *parimin e ndarjes së pushteteve*, sepse Gjykata e Lartë ka shtuar konfuzionin institucional dhe ka deformuar mekanizmin e kontrollit ekzekutiv, duke legjitimuar ndërhyrjen arbitrare. Gjykata ka pohuar se, referuar nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të saj dhe nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile, shkaqet e ankimit kushtetues individual mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimet nr. 32, datë 19.5.2025; nr. 4, datë 21.1.2025; nr. 28, datë 11.4.2024; nr. 63, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimet e reja, të cilat përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues individual, nuk mund të merren në shqyrtim, pasi ato janë paraqitur nga kërkueset pas vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

27. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkueset kanë pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit,* bazuar në argumentin se ato janë trajtuar në mënyrë arbitrare në raport me praktika të tjera të miratimit të shtesave të autorizimit, duke aplikuar një standard të dyfishtë, ndryshe për investitorët e tjerë në energji dhe ndryshe për to. Ndërkohë, Gjykata vëren se këto argumente, në thelb, i referohen procesit administrativ të shqyrtimit të kërkesës së tyre dhe nuk shoqërohen me identifikimin e rasteve konkrete të ngjashme, për të cilat Gjykata e Lartë ka disponuar ndryshe nga ajo çfarë ka vendosur për kërkueset. Në këto rrethana, Gjykata çmon se sikurse me të drejtë kanë prapësuar subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim, pasi argumentet nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

28. Lidhur me pretendimin për cenimin e *së drejtës së pronës,* kërkueset kanë argumentuar se organet e administratës publike dhe ato vendore kanë mbajtur një qëndrim mohues, në kushtet kur investimi nuk mund të vihej në jetë si rezultat i paqartësisë së ligjit dhe veprimeve e mosveprimeve të tyre dhe se vlera e investimit dhe dëmi ekonomik janë të pallogaritshëm dhe katastrofikë. Për këtë pretendim subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se ai qartazi nuk qëndron, për shkak se mungon akti përfundimtar administrativ që njeh të drejtën reale ose ekonomike të kërkueseve, siç mund të ishte certifikata e përdorimit që jepet në përfundim të punimeve, rrjedhimisht në këtë situatë nuk mund të flitet për një pronë të njohur ose të fituar sipas ligjit, e cila të gëzojë mbrojtje kushtetuese.

29. Neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private (*pika 1*), duke parashikuar, ndër të tjera, se prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil (*pika 2*). Gjykata ka pohuar se e drejta e pronës përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme i kësaj të drejte *(shih vendimet nr. 31, datë 18.4.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*. Kjo e drejtë në thelb u referohet vetëm pasurive ekzistuese të individit, përfshirë edhe pretendimet nëpërmjet të cilave një kërkues mund të argumentojë se ka të paktën "një pritshmëri legjitime" (e cila duhet të jetë më konkrete se sa thjesht një shpresë) se do të realizohen, domethënë se do të fitojë gëzim efektiv të një të drejte pronësie *(shih vendimin nr. 30, datë 2.5.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*. Për të nxjerrë kuptimin e së drejtës së pronës, Gjykata i referohet edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*GJEDNJ*), e cila ka pranuar se të ardhurat e ardhshme përbëjnë "posedim" vetëm nëse të ardhurat janë fituar ose janë përfundimisht të pagueshme (*shih Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë [DhM], 11 janar 2007, § 64; Denisov kundër Ukrainës [DhM], 25 shtator 2018, § 137; Juszczyszyn kundër Polonisë, 6 tetor 2022, § 344; Gyulumyan dhe të tjerë kundër Armenisë, 21 nëntor 2023, § 101*). Vëllimi i biznesit që gëzon një profesion i lirë - pa të ardhura fikse dhe pa xhiro të garantuar - i cili u nënshtrohet rreziqeve të jetës ekonomike, nuk përbën një

"pronë" (*shih Federata Greke e Doganierëve, Gialouris dhe të tjerë kundër Greqisë, 6 prill 1995*). Po sipas GJEDNJ-së, shpresa për njohjen e një të drejte pronësie, që ka qenë e pamundur të ushtrohet në mënyrë efektive, nuk mund të konsiderohet si një "posedim" në kuptim të nenit 1, të Protokollit nr. 1 dhe as një pretendim i kushtëzuar që shuhet si rezultat i mospërmbushjes së kushtit (*shih Princi Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë [DhM], 12 korrik 2001, §§ 82–83; Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (vendim) [DhM], 10 korrik 2002, § 69*).

30. Në kontekst të sa më sipër dhe duke marrë në konsideratë rrethanat e rastit në shqyrtim (autorizimi i marrë ka qenë paraprak dhe investimi nuk është përmbushur), Gjykata çmon se nuk ka bazë të arsyeshme që të mbështesë ndonjë pritshmëri legjitime për të drejtën e pronës të kërkueseve. Me fjalë të tjera, interesi pronësor i kërkueseve nuk mund të karakterizohet si një e drejtë e pronës private, në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i tyre për cenimin e së drejtës së pronës nuk qëndron.

31. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, se Gjykata e Lartë ka shqyrtuar në themel shkaqet e rekursit, duke disponuar një vendim diametralisht të kundërt me atë që kanë dhënë gjykatat e faktit dhe në disfavor të kërkueseve dhe, nga ana tjetër, thelbin e argumenteve të parashtruara nga të gjitha palët pjesëmarrëse në gjykimin kushtetues që lidhen me mënyrën e arsyetimit të Gjykatës së Lartë për interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e fakteve të çështjes, çmon ta analizojë këtë pretendim në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, i cili ka natyrë kushtetuese dhe, si i tillë, hyn në juridiksionin e Gjykatës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

32. Kërkueset kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar faktet dhe provat dhe nuk ka dhënë asnjë argument ligjor se përse administrata publike, si ajo në nivel lokal, ashtu edhe në nivel qendror, nuk mori asnjë masë për eliminimin e situatës së paligjshmërisë, lehtësimin e kuptueshmërisë së bazës ligjore dhe nisjen e punimeve. Ndonëse këto shkaqe gjenden të listuara në pjesën përshkruese, në pjesën arsyetuese ato nuk merren në analizë nga Gjykata e Lartë. Sipas kërkueseve, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar faktin se shkresa e sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Ministrave është e paligjshme, në kushtet kur është marrë një prerogativë që ligji nuk e përcakton si kompetencë të detyrës funksionale të tij. Po kështu, ajo gjykatë nuk ka vlerësuar faktin se kërkueset ndodheshin në kushtet e pamundësisë për të kërkuar zgjatjen e afatit të autorizimit përpara mbarimit të afatit, për sa kohë nuk kishin zgjidhur ende mosmarrëveshjen me Bashkinë e Malësisë së Madhe, pasi kjo kohë do të ndikonte në afatin e ndërtimit e, për rrjedhojë, në rast mospërfundimi të punimeve brenda afatit, do të humbnin përfundimisht autorizimet e dhëna me VKM-të.

33. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se Gjykata e Lartë në mënyrë të qartë ka argumentuar se në referim të shkaqeve të rekursit, vendimet e gjykatave të faktit janë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit material mbi rrethanat konkrete të çështjes në gjykim. Për më tepër, pretendimet e kërkueseve kanë të bëjnë me mënyrën e shqyrtimit dhe vlerësimit të provave dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme. Gjykatat e faktit nuk kanë marrë në konsideratë kompetencat e organeve publike administrative. Përkundër kompetencave të tyre, gjykatat e faktit kanë disponuar detyrimin e Këshillit të Ministrave të miratojë projektvendimin, çka është në kundërshtim me ligjin, pasi ato nuk mund t'i përcaktojnë vullnetin vendimmarrës një organi administrativ para se ai ta shqyrtojë sipas bindjes së brendshme dhe diskrecionit të vlerësimit që i jep ligji.

34. Gjykata është shprehur se arsyetimi është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se funksioni i tij është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë *(shih vendimet nr. 31, datë 29.5.2023; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*. Zbatimi i standardit të arsyetimit është vlerësuar nga Gjykata,

rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë *(shih vendimet nr. 50, datë 18.10.2023; nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

35. Po kështu, Gjykata është shprehur se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 7.3.2024; nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 33, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Duke zbatuar standardet e mësipërme kushtetuese në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes të marra në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, Gjykata vëren se kërkueset, në cilësinë e subjektit zhvillues, në vitin 2015 kanë marrë nga Këshilli i Ministrave autorizimet përfundimtare për zbatimin e projektit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltaik me afat përfundimi dy vjet (mars 2017). Për shkak të mosdakordësisë me Bashkinë e Malësisë së Madhe për nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë (0.1% apo 3%), kërkueset nuk kanë mundur të marrin në kohë lejet e ndërtimit për fillimin e punimeve. Situata e mosmarrëveshjes me Bashkinë e Malësisë së Madhe ka zgjatur përreth një vit, nëntor 2016–nëntor 2017, deri kur kjo e fundit u dakordësua pas ndërhyrjes së institucioneve qendrore të ekzekutivit (MIE-s dhe Ministrisë së Financave) për nivelin e taksës 0.1 % mbi vlerën e investimit. Pas kryerjes së pagesës, në muajin janar 2018 kërkueset kanë kërkuar pajisjen me lejen e ndërtimit, por për shkak të tejkalimit të afatit të përcaktuar në VKM-të për dhënien e autorizimit (mars 2017), nuk është bërë e mundur pajisja sipas kërkesës së tyre. Në vijim, pas komunikimeve në rrugë administrative, me qëllim shtyrjen e afateve të punimeve, në muajin dhjetor 2018, MIE ka nisur për miratim në Këshillin e Ministrave tre projektvendime për këtë qëllim. Të tria këto akte i janë kthyer mbrapsht MIE-s nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, me argumentin se nuk janë respektuar afatet e punimeve dhe kërkesa për shtyrje është paraqitur jashtë afateve ligjore. Në këtë situatë, në tetor të vitit 2019 kërkueset kanë vënë në lëvizje rrugën gjyqësore.

37. Gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit, mbështetur në të njëjtën linjë arsyetimi, u kanë dhënë të drejtë kërkueseve, duke detyruar Këshillin e Ministrave të miratojë tre projektvendimet për shtyrjen e afateve të punimeve. Sipas gjykatave, MIE ka përmbushur detyrimin e saj për hartimin e tre projektvendimeve, duke pranuar zgjatjen e afatit të autorizimit dhe ka vazhduar procedurat për miratimin e tyre në Këshillin e Ministrave. Po kështu, gjykatat kanë vlerësuar se Këshilli i Ministrave nuk ka bërë një hetim të plotë të çështjes dhe nuk ka marrë parasysh njoftimet e bëra nga kërkueset drejtuar Këshillit të Ministrave dhe MIE-s, por në kundërshtim me ligjin ka vendosur që të mos pranojë shtesën e autorizimit të bërë nga vetë organi kompetent, MIE. Për më tepër, sipas gjykatave, kërkueset nuk mund të kërkonin zgjatjen e afatit të autorizimit përpara mbarimit të afatit, për sa kohë nuk kishin zgjidhur ende mosmarrëveshjen me Bashkinë e Malësisë së Madhe lidhur me vlerën që duhej të paguanin për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Kjo, pasi zgjatja e afatit të autorizimit jepet vetëm një herë dhe për një afat jo më të gjatë se gjysma e periudhës së ndërtimit dhe, nëse kërkueset nuk do të arrinin të përfundonin punimet brenda afatit, do të humbnin përfundimisht autorizimin. Po kështu, sipas gjykatave, MIE është institucioni që shqyrton dhe vlerëson arsyet e parashtruara nga mbajtësi i autorizimit për zgjatjen e afatit të autorizimit të kërkuar dhe jo Këshilli i Ministrave. Në këtë rast, Këshilli i Ministrave duhej të dilte me një vendim konkret për miratimin ose jo të këtyre projektvendimeve dhe jo të procedonte me një shkresë të sekretarit të përgjithshëm për kthimin e tyre pa një vendimmarrje konkrete. Mosrespektimi i parashikimeve nënligjore lidhur me zgjatjen e afatit të autorizimit për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë (në rastin konkret central elektrik fotovoltaik), bën që veprimi administrativ i kryer nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, i formalizuar me shkresën e datës 9.1.2019, për kthimin e projektvendimeve është veprim i paligjshëm në kuptim të nenit 109 të KPA-së.

38. Përkundër arsyetimit të gjykatave të faktit, Gjykata e Lartë, pasi ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore, në prani të palëve, ka vlerësuar se problematika e çështjes objekt gjykimi lidhet me kuptimin e drejtë të bazës juridike për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, që i referohet nenit 24, të vendimit nr. 1701, datë 17.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar (*Vendimi për Procedurat e Dhënies së Autorizimit*), përmbajtjes së tre vendimeve për miratimin e autorizimit dhe marrëveshjeve të datës 18.3.2015. Konkretisht, shprehet Gjykata e Lartë, kuptimi i ligjit nga një organ publik i pushtetit vendor siç është Bashkia e Malësisë së Madhe, për sa i takon nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk mund të përbëjë në vetvete forcë madhore për të justifikuar mosrespektimin e afateve nga kërkueset. Pushteti vendor nuk është në varësi të pushtetit qendror, ndaj korrespondenca që kërkueset kanë pasur me MIE-n për zgjidhjen e "konfliktit" me bashkinë, nuk justifikon mosrespektimin e afateve prej tyre. Për më tepër, sipas Gjykatës së Lartë, kërkueset kanë paraqitur edhe padi kundër Bashkisë së Malësisë së Madhe, me objekt saktësimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet kërkueseve dhe organit publik për sa i përket masës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga procesi i instalimit të paneleve diellore sipas lejeve ndërtimore të dhëna nga autoritetet kompetente. Padia e tyre është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, ndërsa më pas ato kanë hequr dorë nga ankimi pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Ndaj, "pengesa" ose "vështirësitë" financiare të kërkueseve për mospagimin e masës 3% të vlerës së investimit, siç i kërkohej nga Bashkia e Malësisë së Madhe, në vend të masës 0.1% të vlerës, nuk mund të përbëjnë arsye të mjaftueshme për mosrespektimin e afateve, pasi ato ishin ngjarje që mund të shmangeshin ose nëpërmjet pagimit të taksës dhe më pas zgjidhjes gjyqësish të pretendimeve për paligjshmërinë e nivelit të saj dhe veprimeve të Bashkisë së Malësisë së Madhe, ose nëpërmjet respektimit të afatit 60-ditor të njoftimit sipas parashikimit të shprehur qartë në VKM-të nr. 20-21-22/2015 (*shih paragrafin 41, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po sipas Gjykatës së Lartë, nuk ka dyshime që kërkueset nuk e kanë respektuar afatin për të paraqitur kërkesë për zgjatjen e autorizimit paraprak, i cili duhet të ishte kërkuar dhe paraqitur përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në autorizimin bashkëlidhur VKM-ve nr. 20-21-22/2015. Ndërkohë, shkresat e vitit 2018 të kërkueseve për shpjegime për vonesat e fillimit të punimeve janë bërë rreth 1 vit pasi ka përfunduar afati, duke qenë kështu haptazi në kundërshtim me afatet e kërkuara në aktet nënligjore (*shih paragrafin 42, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

39. Gjithashtu, sipas argumentimit të Gjykatës së Lartë, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Këshillin e Ministrave, ky i fundit ka rol aktiv dhe diskrecionar në drejtim të verifikimit të plotësimit të kushteve për paraqitjen e kërkesës për zgjatjen e afatit të miratimit të punimeve dhe miratimin ose refuzimin e kërkesës. Kjo, pasi ndonëse akti nënligjor i njeh kompetencën ministrisë së linjës për të propozuar miratimin ose refuzimin e kërkesës, mbetet gjithsesi në kompetencën e Këshillit të Ministrave marrja e vendimit përfundimtar për miratimin/refuzimin e zgjatjes së lejes. Rrjedhimisht është nën përgjegjësinë e tij ligjore miratimi i një vendimi të tillë, në drejtim të verifikimit të ekzistencës së kushteve që justifikojnë, apo jo këtë kërkesë (*shih paragrafin 44 po aty*). Disponimi i gjykatave të faktit sipas të cilit detyrohet Këshilli i Ministrave që të miratojë projektvendimet është i pabazuar në ligj, pasi gjykatat nuk mund t'i përcaktojnë paraprakisht vullnetin vendimmarrës një organi administrativ, para se ai ta shqyrtojë çështjen, sipas bindjes së tij dhe diskrecionit të vlerësimit që i jep ligji (*shih paragrafin 46 po aty*).

40. Gjykata vëren se sikurse është shprehur edhe Gjykata e Lartë, në nenin 24 të Rregullores së miratuar me Vendimin për Procedurat e Dhënies së Autorizimit është parashikuar se mbajtësi i autorizimit mund t'i paraqesë ministrisë përgjegjëse për energjinë një kërkesë me shkrim për zgjatjen e afatit të autorizimit, duke dhënë arsyet për zgjatjen e kërkuar dhe se ministria në fjalë, nëse e sheh të arsyeshme, pranon zgjatjen e afatit të autorizimit dhe vazhdon procedurat për miratimin e saj në Këshillin e Ministrave ose në të kundërt, i propozon Këshillit të Ministrave heqjen e autorizimit. Po kështu, sipas këtyre parashikimeve, çdo zgjatje e afatit të autorizimit për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë mund të jepet vetëm një herë dhe mund të jetë jo më e gjatë se gjysma e periudhës së ndërtimit, që përcaktohet në autorizim dhe se mbajtësi i

autorizimit njofton me shkrim ministrinë përgjegjëse për energjinë, jo më vonë se 60 ditë përpara përfundimit të afatit të përcaktuar në autorizim, kur ai e ka të qartë se nuk mund të jetë në gjendje të përmbushë afatin përkatës (*shih paragrafin 38 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Nga ana tjetër, sipas shkronjës "c", të nenit 9, të Ligjit për Këshillin e Ministrave, sekretari i përgjithshëm kthen në bazë të argumenteve ligjore projektaktet e paraqitura për shqyrtim, kur ato bien në kundërshtim me Kushtetutën ose me ligjin. Ndërsa në nenin 24, pika 3, të po këtij ligji, përcaktohet se sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave jua kthen për plotësim ministrave propozues projektaktet, kur ato nuk përmbushin kriteret dhe kushtet e paraqitjes së tyre, të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet e Këshillit të Ministrave, në bazë e për zbatim të tij (*shih paragrafin 45 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

41. Për sa më lart, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të saj.

42. Sipas *njërit qëndrim* u vlerësua se pretendimi i kërkueseve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i bazuar, pasi Gjykata e Lartë, ndonëse ka analizuar parashikimet ligjore që gjejnë zbatim në interpretimin e rrethanave dhe fakteve të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, nuk i ka trajtuar ato të ndërvarura me njëra-tjetrën, duke mos mbajtur në konsideratë faktin se kërkueset kanë qenë në pamundësi objektive dhe përtej vullnetit të tyre për të përmbushur dhe realizuar projektin sipas autorizimeve të marra nga Këshilli i Ministrave. Ajo nuk ka marrë parasysh se ndërmjet kërkueseve dhe institucioneve vendore dhe qendrore ka pasur një komunikim aktiv dhe të shpeshtë për të zgjidhur situatën e krijuar nga bashkia dhe jo nga kërkueset. Konkretisht, në proces janë përfshirë 5 institucione të nivelit qendror – Këshilli i Ministrave, MIE, Ministria e Financave, MSHMS-ja dhe AZHT-ja, të cilat edhe ndërmjet tyre kanë pasur komunikime për sa i takon interpretimit ligjor për nivelin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, megjithëse ligji e parashikonte qartësisht nivelin e taksës, gjë e cila u konfirmua edhe nga Ministria e Financave. Situata e krijuar nga bashkia ndërkohë ka sjellë pengesa që kërkueset të përmbushnin në kohë detyrimet e tyre. Kjo çështje dhe dinamikat e saj nuk janë analizuar dhe as vlerësuar me objektivitet nga Gjykata e Lartë, duke bërë që arsyetimi i saj formalisht të mbështetet vetëm në parashikimet ligjore pa marrë në konsideratë rrethanat dhe faktet e çështjes, për më tepër të provuara dhe të pranuara edhe nga vetë institucionet. Në këtë kontekst, pjesa arsyetuese e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë rezulton të jetë formaliste dhe jokoherente në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes, duke e larguar qëllimin e procesit nga vetë thelbi i së drejtës kushtetuese. Thënë kjo, interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, në rastin në fjalë, i mungon analiza nga pikëpamja e faktit, duke e bërë atë formalist. Parë në këtë këndvështrim, kërkesa duhet pranuar dhe Gjykata duhet të disponojë shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.[4]

43. Ndërsa sipas *qëndrimit tjetër*, pretendimi i kërkueseve për cenimin e standardit të arsyetimit është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë arsye të mjaftueshme për vlerësimin e saj në raport me dispozitat ligjore të aplikueshme që e kanë çuar në zgjidhjen e çështjes sipas përmbajtjes së dispozitivit. Vendimi rezulton të jetë i qartë në përmbajtje dhe pjesët përbërëse të tij janë të lidhura me njëra-tjetrën, ndërsa pjesa arsyetuese paraqet interpretimin ligjor bazuar në rrethanat dhe faktet e çështjes, që nuk përmban gabime faktike ose ligjore. Për rrjedhojë, në kundërshtim nga sa kërkueset pretendojnë, interpretimi nga Gjykata e Lartë i kuadrit ligjor të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, nga këndvështrimi kushtetues, nuk rezulton të jetë i paarsyeshëm, duke qenë se ajo si gjykatë ligji ka parashtruar në vendimin e saj në mënyrë të plotë të gjitha argumentet ligjore mbi bazën e të cilave ka arritur në përfundimin e paraqitur në dispozitiv. Parë në këtë këndvështrim, Gjykata e Lartë nuk ka cenuar standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor e rrjedhimisht kërkesa duhet rrëzuar.[5]

44. Në përfundim, Gjykata konkludon se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të saj, kërkesa e kërkueseve konsiderohet e rrëzuar.

[4] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Marjana Semini.

[5] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi dhe Ilir Toska.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 2.12.2025.
Shpallur më 13.1.2026.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari
Anëtarë: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi

VENDIM
Nr. 347, datë 29.12.2025

MBI MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT MBI EMERGJENCËN DHE RIVENDOSJEN

Në mbështetje të neneve 16, 20, germat "a", 23, pika 1, germa "b", 30 pika 2 dhe 90, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 3142 prot., datë 24.12.2025, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, "Mbi miratimin e 'Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen"',

konstatoi se:

- Shoqëria "OST" sh.a., me shkresën nr. 2903, datë 26.5.2025, të protokolluar pranë ERE me nr. 1739, datë 30.5.2025, ka paraqitur kërkesën për miratimin e "Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen" si akt transpozues i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2196, datë 24.11.2017, "Për krijimin e Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen".

1. Fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së "OST" sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 292, datë 13.11.2025, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e "Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen".

